

JORGOS FILIPOU PIERIDHI

TETRALOGJIA E KOHËVE

TREGJIME

BOTIMET TOENA

JORGOS FILIPOU PIERIDHI

TETRALOGJIA E KOHËVE

tregime

Përktheu nga origjinali greqisht
Kristo Pulla

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2019

Autori: G. Philippou Pierides
Titulli në origjinal: Η Τετραλογία των Καιρών
Botoi në greqisht: Fondacioni Kulturor i Bankës së Qipros, Nikozia
1989

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Albina Pulla
Korrektore letrare dhe përkujdesja grafike: Edona Marku
Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-58-9

©1989, G. Philipou Pierides & Fondacioni Kulturor i Bankës së Qipros,
Nikozia

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me
asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të
mbajtësit të copyright-it.

Botimet TOENA
Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
Email: redaksia@toena.com.al
botimet.toena@gmail.com
www.toena.com.al

PARATHËNIE

Fondacioni kulturor i bankës së Qipros, në vazhdimësi të interesimit që tregon në praktikë për krijimtarinë e denjë letrare të Qipros, përgatiti botimin e librit “Tetralogjia e Kohëve”, të prozatorit Jorgos Filipou Pieridhi.

Botimi përmban katër përmbledhje tregimesh dhe tri tregime të pabotuara më parë të shkrimtarit, vepër e cila, me konceptim shembullor dhe gjuhë të denjë, përshkruan faqe të historisë së vendit gjatë tridhjetëvjeçarit të fundit të shekullit.

Me këtë botim, ne dëshirojmë të nderojmë një krijues të denjë qipriot, i cili, gjatë gjithë këtyre viteve, përbën një prani vigjilente, shpirtërore dhe morale në vend, dhe paralelisht të japim pamjen e plotë të një vepre në prozë që nderon krijimtarinë letrare neohelenike.

Vendimin për botimin e “Tetralogjisë së Kohëve” e mori seanca plenare e Këshillit Drejtues të Fondacionit më datë 9 shkurt 1989.

Andreas Pacalidhis

Kryetar i Fondacionit Kulturor të Bankës së Qipros

SHËNIMI I AUTORIT

Ngjarjet tronditëse të periudhës 1955-1959 në Qipro, më nxitën - ashtu si nxitën dhe krijues të tjerë - në përpjekjen dhe për të përshkruar (me mënyrën time, natyrisht, dhe nga këndvështrimi im shpirtëror dhe emocional) zhvillimet dhe klimën e asaj periudhe. Ky dhe vetëm ky ishte qëllimi im atëherë.

Por kur përfundova përmbledhjen me tregime mbi këtë temë, që i vura titullin “Kohë të ashpra”, dhe e dorëzova për botim (1963), mendova ta plotësoja veprën time me dy seri tregimesh që t’i referoheshin: a) Viteve para 1955-s, kur Qiproja ishte një koloni angleze, dhe b) periudhës pas pavarësisë gjysmake të vitit 1960. Me këtë qëllim punova për dy përmbledhjet me tituj “Kohë të qeta” dhe “Koha e të vetëkënaqurve”, të cilat u botuan respektivisht në vitin 1966 dhe në vitin 1975.

Kjo është arsyeja që botimi i përmbledhjeve “Kohë të ashpra” dhe “Kohë të qeta”, nuk korrespondojnë me rendin kronologjik të përmbajtjes së tyre.

Përmbledhja e katërt, “Koha e të vetëkënaqurve”, botim i vitit 1978, i referohet grushtit të shtetit dhe ndërhyrjes turke të vitit 1974.

Në këtë botim të “Tetralogjisë së kohëve”, që u realizua nga Fondacioni Kulturor i Bankës së Qipros, me të drejtë u gjykua që dy përmbledhjet e para të vendosen sipas rendit kronologjik të përmbajtjes së tyre, në mënyrë që e gjithë vepra të përftojë vazhdimësinë e vet logjike.

J. F. P
Shtator 1989

KOHË TË QETA

TREGIME NGA QIPROJA TJETËR

STOLIA E FUNDIT

Në mëngjes, derisa dielli të ngjitet lart në qiell, mëhalla e vjetër shtriqet, në përpjekje për të larguar mpirjen nga vetja. Në vazhdim, gjallërohet paksa me lëvizjet që kanë filluar te tregu, i cili i zgjat deri këtu tentakulat e tij, me tingujt, që mbërrinë si një buçimë e largët nga qendra e qytetit të vogël, me grupet e fëmijëve që nisen për në shkollë duke shpërndarë nëpër rrugë ylberizime ngjyrash dhe zërash, me amvisat e shtëpive që hapin dritaret dhe shkundin shtrojat, me shërbëtoret njomcake që vrapojnë zbathur për të kryer porosinë... Dhe kjo vazhdon deri në drekë. E pastaj lagjja bie përsëri në letargji.

Dy apo tri orët menjëherë pas drekës janë ato me më pak lëvizje. Rrugët e shkreta, dritaret e mbyllura të shtëpive, pemët e pakta që nxjerrin krye të dëshpëruara mbi muret e oborreve të shtëpive, zhyten në heshtje dhe ngjajnë të braktisura.

Dhe vetëm pasdite vonë, një puls i dobët na zbulon përsëri praninë e mbytur të jetës; një puls që e programojnë prani të vetmuara dhe britma, që përsëriten me të njëjtën monotoni.

Rreth orës pesë, gazetashitësi do të lajmërojë mbërritjen e gazetës *Kirika*, e cila ka qarkulluar në të gdhirë në Nikozi

dhe këtu sapo mbërriti. “Mbërriti *Kirikas*”, do të thotë me vete zonja Evllalia Kaneli, e cila qëndron në dhomën e saj të ndenjjes dhe pret, pa e ditur as vetë se çfarë. Do të tundë kokën në mënyrë kuptimplotë, sikur në atë moment ta kuptonte se ndodhi pikërisht ajo që priste, dhe do të dërgojë shërbëtoren njomcake t’i sjellë gazetën për të lexuar vetëm një rubrikë, atë sociale, për të parë se cilit prej kushërinjve dhe të afërmve të saj të panumërt, që ndodhen të shpërndarë në të gjithë ishullin, do të duhet t’i dërgojë një letër urimi apo ngushëllimi, të formuluar në mënyrë të përshtatshme për çdo rast dhe sipas pozitës hierarkike apo lidhjes farefisnore të marrësit të letrës.

Në vazhdim do të dëgjohen me radhë - dhe të ndara nga intervale të gjata heshtjeje - boria e akulloreshitësit... kulaçepjekësi me kulaçet e pasdites... dhe i fundit, në të ngrysur, do të dëgjohet Salihu, turku, që do të mbushë lagjet me thirrjen e tij, të cilën e përsërit, po njësoj, që prej njëzet vjetësh, në po të njëjtën orë, sikur i dërgon një mesazh të fundit diellit, që tashmë ka perënduar. “Ajran!”, “Dhallë!”, lëshon thirrjen e parë, të shkurtër, thua se po bën provë, dhe menjëherë do ta përsërisë thirrjen në mënyrë melodike dhe të zgjatur, duke e përthyer zërin sipas një shkalle në ngjitjeje ngjyrash, sikur notat muzikore të ishin shkallë dhe po i ngjit një e nga një, për të përfunduar në një interpretim tingëllues “A-a-j-j-ra-a-a-nnn”.

Pasi Salihu të japë sinjalin që prisnin, dy nga tri dyqanet e vogla, bakalli i cepit të rrugës dhe kinkaleria, mbyllen.

Dyqani i tretë, *Minimarket dhe Pijetore Izmiri*, është në fakt një tavernë e vogël. Por, nëse je i huaj dhe të ka ardhur në majë të hundës duke parë përreth atë ambient provincial të shpifur, të njëtrajtshëm, dhe gërryes, këtu brenda do të

ndihesh mirë. Tri tavolinat e vogla, të shtruara me mbulesa të thjeshta prej pambuku, prodhim vendi, me kuadrate të bardha dhe të kuqe, banaku që shkëlqen, kurtinkat me viza shumëngjyrëshe te dera prej xhami, pema e madhe te cepi, mbushur me gjethe jeshile, raftet e mbushura me mallra, mënyra shijehollë me të cilën gjithçka është vendosur në vendin e vet, krijojnë një atmosferë miqësore dhe të gëzueshme.

Duke ndjekur rrugët e çuditshme që ravijëzon fati i njeriut, Liza nga Izmiri përfundoi te ky lokal i vogël, nën hijen e shtëpive dikur aristokrate, që sot ngjanin si rrangalla, të qytetit më të harruar ndër qytetet e vogla të Qipros.

Kështu rrodhën ngjarjet. Duke kaluar në qytet me një trupë teatrale, e dashuroi Haritoja, dhe u martua me të. Harito muzikanti, një njeri ëndërrimtar që i përkiste një bote tjetër, i cili jetonte duke dhënë mësimë - për violinë, mandolinë apo piano - por pjesën më të madhe të kohës e kalonte duke bredhur fshatrave, duke dëgjuar këngëtarët vendas që i shoqëronin orkestrantët dhe t'i hidhte këto në pentagram.

Jetonte si varfanjak, dhe kishte si mbështetje të vetme këtë shtëpi, e vetmja pronë që i mbeti nga pasuria e konsiderueshme që trashëgoi nga prindërit, dhe që i iku nga duart, pa e kuptuar as vetë.

Liza, së cilës kishte filluar t'i kalonte pak mosha, pranoi martesën modeste që i ofroi fati. Veç të tjerash, e shtynte dhe një dëshirë e zjarrtë për të mbrojtur nën krahët e saj, këtë fëmijë të pambrojtur, me trupin kockë e lëkurë, kostumin e

zi të dalëboje dhe sytë ëndërrimtarë, që vështronin gjithçka duke pasur besim në të, dhe nëse provoje t'i tregoje që të shihte disa fytyra tinëzare, që fshihen nën shtresën e trashë të makijazhit, ai buzëqeshte i ndrojtur, si i zënë në faj. Sigurisht që Haritoja nuk ishte fëmijë. Ishte më i madh se ajo, ishte dyzet vjeç kur u njohën. Por Liza kështu e shihte - si fëmijë.

Përveshi mëngët dhe mori në dorë frenat e shtëpisë së saj dhe nuk u gjunjësua para zonjave të rëndësishme të qytetit, që ngrinin hundën përpjetë për ta mbajtur aktoren në distancën e duhur. Por Liza nuk ishte budallaqe, që t'i linte të kuptonin se sa i përçmonte të gjitha ato pata të krekosura. Kishte një mirësjellje të lindur dhe shumë lirshmëri në mënyrën se si sillej, në mënyrën se si vishej, në mënyrën se si tregohej indiferente ndaj budallallëqeve që mbanin nën zgjedhë jetët e këtyre zonjave. Dhe zonjat e rënda, e kuptuan, më në fund, se kjo shejtan-femër, jo vetëm që ishte e pacenueshme ndaj përpjekjeve që ato bënin për ta poshtëruar, por në rast nevojë kishte dhe si rezervë një gjuhë të mprehur, të aftë për t'i treguar vendin, me dy fjalë të vërteta të thëna prerazi, zonjës më fodulle. Kuptuan dhe pranuan në heshtje një gjendje kompromisi, që, pa i dhënë Lizës të drejta të barabarta, i njihte të drejtën të mos pranonte ofendime, të shkonte në Mitropoli ditët e shënuara që t'i shprehte edhe ajo, ashtu si të tjerat, respektin e saj Hirësisë së tij, të rrinte ulur këmbë përmbi këmbë në klub dhe të tymoste, e vetmja ndër të gjitha gratë, pa qenë e domosdoshme që të tjerat të shtireshin si të tmerruara nga këto bëma të saj.

Por meritën që ia njihnin pa nguruar, si në sy të saj ashtu dhe kur ajo nuk ishte e pranishme, ishte aftësia që tregoi për të administruar financat e Haritos. Kjo gjë, domethënë respekti për paratë dhe aftësia për t'i mbajtur fort ato e për të gjetur mënyra për t'i shtuar, ishte një virtyt i qartë, që lidhej drejtpërdrejt me shpirtin e tyre. Lidhur me këtë çështje, Liza fitoi të gjithë konsideratën e tyre. Që në muajt e parë pas martesës së tyre, gjeti mënyrën për të kujtuar disa prindër të nxënësve të Haritos, të cilët harronin të paguanin detyrimet për kurset. Kontrollonte fije për pe llogaritë si dhe peshoren e bakallit, dhe nëse në të rrallë blinte ndonjë rrobë për vete apo për Hariton, e blinte me *sytë hapur* dhe *dorën shtrënguar*.

Me kalimin e kohës, duke marrë dhe një kredi nga banka, ia doli ta shndërrojë shtëpinë e madhe prindërore të Haritos, që kishte zënë merimanga, në një apartament të organizuar më së miri, me oborr në pjesën e prapme, ndërsa në pjesën ballore, një dyqan që do ta lëshonte me qira.

Dhe kur Marku, bakalli te cepi i rrugës, u shqetësua nga disa fjalë që qarkulluan - se gjoja Liza do t'ia lëshonte dyqanin me qira dikujt që donte ta bënte dyqan bakalli - dhe i ofroi tri lira në muaj që ta merrte ai vetë me qira, Liza i kërkoi tetë! Marku shkulte flokët dhe qahej se po e shkatërronte, por ndërkohë e ngrinte vazhdimisht ofertën e tij, derisa arriti te pesë lirat. Gjithsesi aktorja nga Izmiri nuk lëvizte nga e vetja, dhe kishte shumë mundësi që të arrinin marrëveshje për gjashtë lira në muaj. E pra, ky ishte momenti që e admiruan të gjitha zonjat.

Por Liza nuk arriti ta jepte dyqanin me qira, sepse, ndërkohë Haritoja u sëmur dhe, derisa u ndërgjegjësuan për seriozitetin e gjendjes së tij shëndetësore, ai vdiq.

E keqja i erdhi Lizës si rrufe në qiell të hapur, e befasishme, e egër, kohëshkurtër.

Liza së bashku me ata miq të pakët të Haritos, që nxituan për ta ndihmuar, në fillim nuk i kushtuan rëndësinë e duhur. Por, nga njëra ditë në tjetrën, të shqetësuar, të merakosur, tërësisht të zhgënjyer ngaqë nuk mund të bënin asgjë, nuk po gjenin ngushëllim dhe po përballeshin me një makth. Vetëm Haritoja duronte në heshtje gjersa u shua pa iu larguar nga buzët ajo buzëqeshje mikpritëse, që i ishte bërë shprehja e gjithë jetës së tij.

Liza ia mbylli sytë, mblodhi të gjitha fletoret dhe shënimet e tij, deri te fleta e fundit, i ruajti me përkushtim dhe pastaj filloi të mendojë se çfarë do të bënte këtej e tutje.

Mbajti dyqanin.

Dhe pas disa muajsh, pasi vrapoi poshtë e lart dhe u furnizua me gjithçka që i duhej, hapi *Minimarket dhe Pijetore Izmirin*.

Marku u tërbua. Disa zonja bënë sikur u skandalizuan. Por shumica e banorëve të lagjes e kuptuan. Si mund ta nxirrte ndryshe bukën e gojës e shkreta, si do ta shlyente kredinë? Gjithashtu, tashmë ishin mësuar ta pranonin mes tyre Lizën si një rast të veçantë, e papërkulur ndaj atyre që duheshin bërë dhe atyre që nuk duheshin bërë, të cilat komandonin jetën e tyre. Madje disa gra e admironin në fshehtësi. Aktore a stëraktore, ato gra të nënshtruara, e ndienin se kjo grua-shejtan, me mënyrën e saj kishte sjellë në atë skllavëri që e bënte gjithçka rreth tyre të mërzitshme, njëfarë mesazhi pavarësie personale dhe guximi. E mbështetën. Dhe dolën të fituara, sepse Liza nuk tentonte t'ua hidhte.

Kishte dhe disa pasanikë, si tregtari i madh Nikitaidhis, zoti Llukia, gjykatës në pension, drejtori i Kadastrës, mjeku Kanelis, zoti Zulios fotografi, tifoze të mezes së shijshme, që konstatuan se kjo grua nga Izmiri nuk e kishte shoqen për mezet që përgatiste. Gjithmonë kishte diçka të veçantë për të shërbyer, herë oktapod në prush, herë sallatë me peshk të tharë, një herë tjetër *lluz*, sallam me erëza apo dhe mish derri të tymosur shoqëruar me patate të saposkuqura që kërcisnin në gojë, pra, gjithmonë diçka të re, dhe si rezultat merrte prej tyre të njëjtat fjalë inkurajuese.

- Nejse, Liza, je mjeshtrë e mrekullueshme në përgatitjen e mezeve.

Dhe gjithmonë e njëjta përgjigje vetëkënaqësie.

- Kështu jemi ne nga Izmiri.

Vinin darkave për të kthyer ndonjë gotë, të shkëmbenin ndonjë batutë, të çliroheshin për pak nga mërzia që i kaplonte, para se të shkonin në shtëpitë e tyre.

Klientët më të rregullt ishin Zulioja, që pinte më tepër se një gotë dhe Liza mërzitej me të, sepse me gjithë kravatën e tij *lavalier* dhe flokët e dendur ngjyrë gri që i jepnin një pamje artisti, nuk pushonte së foluri. Dhe mjeku, që e tërhiqte këtu nostalgjia për atdheun e tij. Ishte edhe ai nga Azia e Vogël, e kishte përfunduar këtu si refugjat.

Por mjeku dallonte, dallonte nga të gjithë njerëzit, ishte njeriu i mirë që kaloi, si një bekim prej Zotit, mes nesh për të lënë të gdhendur në zemrat tona një vulë njerzillëku.

Nga të gjithë ata që e njohën, nuk gjendet as edhe një në qytetin tonë të vogël dhe fshatrat përreth që të mos e kujtojnë me dashuri Stathi Kanelin, mjekun, me kokën e tij të madhe të qethur, me sytë e tij të qeshur ngjyrëkafë të florinjte, dhe

duart e tij me gishtërinj të gjatë, që dinin të preknin, si me sy ashtu dhe me duar, butësisht dhe në mënyrë ngushëlluese, të gjitha dhimbjet.

Nuk pinte kurrë gjë tjetër përveçse një gotë verë, “të bardhë, të thatë”. Por i pëlqenin mezet e mira dhe e shfaqte gëzimin e tij si një fëmijë i vogël, kur Liza i ofronte diçka orientale.

“Qofte Izmiri! Mmm!...”, ia bënte duke fërkuar duart e tij në një mënyrë të tillë, saqë kujtoje se do të hante një pjatancë të tërë.

Provonte një, edhe një tjetër, pinte dy gllënjka verë dhe ndalonte.

- Merr, zoti doktor, përderisa ju pëlqejnë, - i thoshte Liza.

- Janë të mrekullueshme, - thoshte ai, por nuk merrte tjetër.

E dinte se këtë gatim të shijshëm, Liza e kishte hequr nga pjata që kishte përgatitur të hante vetë për darkë. Dhe nga ana tjetër, mendonte se do të mërziste zonjën Evllalia, gruan e tij, nëse shkonte në shtëpi i ngrënë.

Zonja Evllalia i përkiste një prej shtëpive më aristokrate të vendit, dhe ishte në moshë të madhe, kur prindërit e martuan me mjekun refugjat të porsaardhur, sepse i kishin peshuar mirë vlerat e tij.

Ajo kishte pikëpamje dhe shprehi aristokrateje dhe nuk e simpatizonte prirjen e të shoqit për t’u sjellë si njerëzit e thjeshtë. Kundrejt Lizës sillej me dashamirësi, ngaqë mendonte se kështu i shkonte për shtat një zonje mondane në “rrethana të tilla”. Megjithëse nuk e mori mundimin ta diskutonte këtë çështje, Kaneli e kuptonte se çfarë

dyshimesh e brenin të shoqen për marrëdhëniet e tij me Lizën, dhe kjo i dukej qesharake. Ai ishte i sigurt se zonja Evllalia, jo vetëm që nuk vuante, por përkundrazi, shpirti i saj romantik e shijonte rolin e superioritetit melankolik që kishte thurur për veten me fantazinë e saj.

“Ç’të bëjë dhe ajo?”, thoshte me vete. “Interpreton me vete role imagjinare, ngaqë mërzhitet.”

Por kush është ai që mund të qëndrojë vazhdimisht në lartësinë e vetes së tij imagjinare? Shpejt zonja Evllalia zbriste përsëri në nivelin e vetvetes reale, në përditshmërinë e zakonshme dhe përkujdesjet e thjeshta, duke llogotitur pa pushim dhe duke u grindur. Dhe mjeku priste me durim. Vetëm se:

“Nuk quhet Efthalia gruaja ime, biri im”, i tha dikur një djali të ri, i cili, duke gabuar në shqiptimin e emrit të saj, iu lut t’i përcillte përshëndetjet e tij zonjës Efthalia. “Nuk quhet Efthalia. Për fat të keq, quhet Evllalia.”

Të paktën t’i falte një djalë! Por jo. Fëmija i tyre i vetëm ishte vajzë.

Por, ndërkohë, edhe kjo nuk kishte më rëndësi, sepse teksa Marieta rritej dhe me praninë e saj mbushte shtëpinë dhe zemrën e doktorit, merakun e tij po harrohej.

Derisa Marieta të mbaronte filloren, Kaneli ishte i sigurt se në kohën e sotme, një vajzë mund të ecte përpara dhe t’ia kalonte prindit, njëlloj si një djalë. Dhe kur e bija mbaroi gjimnazin, e dërgoi në Athinë për të studiuar për mjekësi.

Sa shumë u gëzua në atë kohë Liza dhe si ua priste me padurim fjalën atyre që e gjykonin vendimin e Kanelit si të guximshëm për traditat patriarkale të vendit tonë.

- Flini gjumë ju, - u thoshte. - Në Europë ore, gratë u bënë madje edhe ministre.

Po ç'të drejtë kishte Liza të fliste për këtë çështje? Asnjë. Por nuk mund ta linte pa i dhënë përgjigje çdo kukuvajke, që kujtonte se vetëm errësira është gjë e mirë dhe guxonte të vinte në dyshim gjykimin e doktorit dhe të drejtat e një vajze si Marieta. A thua se nuk e shikonin se sa i kushtonte ky vendim?

- Do ta kërkosh zoti doktor, vajzën tënde nesër që do të të mungojë, - i shpëtoi goja dhe i tha një ditë Liza.

- E di, zonja Liza, e di, - ia bëri ai, sikur fliste me vete, dhe u zhyt përsëri në heshtjen e tij.

Kur e shihte kështu të heshtur, Liza e kuptonte se në ç'masë ky njeri gojëmbël, ishte, në thelb, i zhytur në vetminë e tij. Por ndërkohë, ishte një heshtje që nuk rëndonte, vetëm sa përhapej mes tyre si një zgjatim i qetë, mbushur plot me fërfëllima pozitive. Me Kanelin, mund të rrije me orë të tëra pa folur, pa u mërzhitur. Liza pushonte së rëni lokalit kryq e tërthor dhe rrinte e qetë në një qoshe.

Por kur me shpërthimin e luftës dhe pushtimin e Greqisë nga gjermanët, Marieta u gjend e izoluar në Athinë dhe muajt kalonin pa marrë lajme prej saj, heshtja e Kanelit u bë e rëndë, sepse vetmia e tij i kapërceu kufijtë e durimit të tij. Megjithatë, përpiquej të luftonte kundër rrymës që i shkaktonte ankthi dhe padurimi i tij personal, duke parë me kthjelltësi dimensionet e dhimbjes njerëzore dhe duke vazhduar t'u përkushtohet pacientëve të tij dhe njerëzve të vuajtur, të cilët ishin mësuar të kërkonin tek ai një mbështetje.

Për gruan e tij i vinte keq, por si mund t'i gjendej pranë, kur e shihte të përballonte të njëjtin ankth nga i cili vuante

dhe vetë, në një mënyrë krejt të kundërt nga mënyra me të cilën e përballonte ai? Zonja Evllalia e shtriu tani kureshtjen e saj në çdo drejtim, lexonte të gjitha lajmet dhe artikujt e gazetës *Kirika*, ndiqte peripecitë e operacioneve luftarake dhe aventurat e zhvillimeve politike, por me një mënyrë të vetën arsyetimi qendërsynues, ia dilte të fokusonte gjithçka te vetja dhe te oscilacionet e shpresave të saj për ardhjen e Marietës.

Por këto janë histori e vjetër.

Kur, më në fund, pas çlirimit, Marieta mundi të kthehej në vendin e vet, nuk e gjeti të gjallë babanë e saj. Por as ajo vetë nuk ishte më ajo vajzë me faqe të kuqe si trëndafil, që me vështrimin e saj të qeshur, ndriçonte mijëra të vërteta shumëngjyrëshe. Nga ato lule u lidh tashmë një frutë i papjekur, që me faqet e thelluara, buzët e shtrenguara, sytë që shpesh gjysmë të mbyllur përqendroheshin te një pikë e largët, paraqiste të gjitha shenjat e rrugës së vështirë që të çon nga kudhra e sprovës drejt pjekurisë shpirtërore.

Të gjitha zonjat, që vajtën në shtëpinë e saj për t'i uruar mirëseardhjen, provuan zhgënjim përballë mungesës së gatishmërisë së saj për të kënaqur kërshërinë e tyre të pashtershme.

- Marieta, besoj se vuajte shumë, e shtrenjta ime. Ti, që ishte mësuar me të gjitha të mirat, - fillonin me radhë secila prej tyre.

Por Marieta nuk fliste shumë, vetëm buzëqeshte me dashamirësi, dhe dukej sikur mendja e saj fluturonte gjetiu. Edhe ato gjëra të pakta që tregonte, i referoheshin dramës që kishte përjetuar gjatë pushtimit, në mënyrë të përgjithshme dhe të papërcaktuar.

- Zot na ruaj, - pëshpëritnin mes tyre zonjat. Disave u dukej sikur Marieta ishte bërë me fiksime, ndërsa disa të tjera mendonin se ishte bërë mendjemadhe.

Madje edhe Liza, që nxitoi me një dëshirë të zjarrtë dhe të pazakontë për ta takuar, u kthye në dyqan e menduar.

“Diçka mendon”, tha me vete për Marietën.

Papritur, një mëngjes erdhi dhe e takoi Lizën në dyqan. Kishte veshur një fund ngjyrëkafe dhe një triko të hollë, në po atë ngjyrë, vetëm pak më të çelët, me një jakë të vogël të bardhë prej linoje. Veç jakës, që ishte e bardhë borë dhe e sapohekurosur, asgjë tjetër në veshjen e saj nuk tregonte përkujdesje të veçantë. Ndërkohë që paraqitja e saj, tregonte se kishte shije dhe bukuri të lindur.

U ul dhe, teksa vuri njërën këmbë përmbi tjetrën, Liza po admironte pulpat e derdhura, kyçet e holla të këmbëve, harkun e shputave, që ravijëzoheshin dallueshëm.

“Si mbretëreshë!”, tha me vete, dhe nxitoi t’i shërbente vajzës.

Por dukej sikur Marieta nuk vinte re asgjë, vetëm rrinte lirshëm, por e përqendruar sikur aty ishte vetëm me veten e saj, dhe vështronte matanë sheshit të zbrazët, në drejtim të detit, i cili nuk dukej nga ai pozicion.

Lizës i erdhi ndër mend doktori. Kështu i heshtur rrinte edhe ai, por nuk i mbante dhëmbët shtrënguar.

U ul në krah të vajzës së re dhe priste. Derisa:

- Më fol për veten tënde, zonja Liza, si po të ecin punët?
- tha Marieta dhe u kthye duke e vështruar me dashamirësi.

Liza sa nuk u hodh përpjetë nga gëzimi.

- Mirë, moj bijë. Ja, kështu. E shtyjmë.

- E shleve kredinë? - pyeti tjetra, siç pyet një njeri i cili nuk u gjen asnjë kuptim gjërave të përgjithshme dhe të papërcaktuara.

Liza iu përgjigj duke i treguar hollësisht. Sa kishte shlyer, sa i kishin mbetur për të shlyer, gjëra të vogla tashmë.

- Si ia kaluat në përgjithësi gjatë gjithë kësaj kohe?

Ky interesim po i pëlqente Lizës. I përshkroi mirëqenien ekonomike që njohu vendi gjatë periudhës së luftës. Qarkullim mallrash, baza ushtarake, ushtarë anglezë të mirëpaguar që nuk hezitonin të shpenzonin...

- Nuk vuajtëm ne këtej. Përkundrazi, them se ia kaluam mirë.

Tjetra dëgjonte me vëmendje.

- Janë dhuratat e ndyra të luftës, - tha në fund, duke rrudhur buzët.

Në një ballkon, në anën tjetër të sheshit, doli një grua e bëshme duke tërhequr zvarrë një qilim. E pati të vështirë derisa ta varte te kangjellat e ballkonit dhe filloi ta godiste fort me një shkop, thua se po i binte alarmit. Shkretia e lagjes u zu e papërgatitur nga këto goditje, që i kthente menjëherë mbrapsht si jehonë.

- Sa të ngarkuara emocionalisht me këto gjëra ishin ëndrrat e mia atje ku isha, - tha Marieta me një mënyrë që tregonte qartë habinë e saj përse tani tregohej kaq indiferente ndaj tyre.

- Por është vendi yt, Marieta ime, - i tha Liza. - Për më tepër, këtu ti je më e mira ndër të parët. Mund ta ndërtosh jetën tënde ashtu siç dëshiron.

- Beson edhe ti, zonja Liza, se sigurimi i mirëqenies është i mjaftueshëm që të mbushë jetën e një njeriu? Apo...

Por nuk kishte dëshirë të vazhdonte. Si mund t'i shpjegosh tjetrit pikëpyetjet që torturojnë mendimet e tua, t'i tregosh ato që panë sytë e tu, t'i flasësh për rrugët nga të cilat kalove për të kuptuar se sa larg janë ato kohë, në të cilat brenda këtyre shtëpive të rrënuara fisnikësh, u gëzuan, por edhe u hidhëruan njerëz të gjallë!

Ky ngacmim i Lizës në lidhje me faktin që ajo i përkiste parisë, i çoi me një ndërvarësi të çuditshme mendimet e Marjetës te fotografia e gjyshit të saj, që e zverdhur nga koha varej në sallën e mbledhjeve të bashkisë, së bashku me të dy kryetarëve të tjerë të bashkisë që kishin vdekur. Haxhi Piera, me festen e tij dhe vetullat e dendura pothuajse të bashkuara, shikonte me një vështrim të vrazhdë, thua se i mëshironte pasardhësit për gjendjen ku ishin katandisur. Sa e ndiente Haxhi Pierën, hijen e tij të rëndë dhe të dëshpëruar, që me kaq këmbëngulje refuzonte të pranonte se tashmë nuk ishte asgjë. Madje as hije. “A është e mundur që Liza të besojë se kanë ndonjë farë kuptimi në kohën tonë, ofiqet familjare?”, mendoi Marieta.

Liza ishte e lëkundur në mendimet e saj. Një moment qetësohej, me mendimin se kjo Marietë nuk ndryshonte fare nga ajo Marieta që priste, vetëm se ishte e lodhur. Dhe në momentin tjetër mendonte se e kishte gabim, se Marieta e fantazisë së saj nuk ekzistonte, përderisa edhe vetë ajo nuk ekzistonte për këtë vajzë të largët dhe të mbyllur në vetvete që qëndronte para saj.

- Për më tepër, si mjeke, do të ecësh në gjurmët e babait tënd, - vazhdoi ajo në një mënyrë joshëse, thua se po hapte një derë të florinjte.

Marieta gufoi nga gëzimi.

- Asgjë këtu brenda nuk është për mua aq e shtrenjtë, sa kujtimi i tim ati, - ia ktheu.

Por menjëherë rrudhi ballin dhe vetullat iu bashkuan. Vetë fjalët e saj tingëllonin si banalitete emocionale dhe shkatërronin magjinë e gjithçkaje që ndiente para ndjenjave të dashurisë që ajo pa të bashkonin zemrat e kaq njerëzve të thjeshtë në kujtim të mjekut. Ajo që rrezatonte brenda saj ishte kaq e butë, kaq mallëngjyese, kaq larg konvencionalitetit të fjalëve...

Liza e kuptoi. Por edhe kësaj radhe shpresat e saj ishin të kota. Vajza nuk ia hapi zemrën, vetëm vazhdoi të qëndrojë pa lëvizur, me vështrimin ngulur në mendimet e saj.

“Ka ashpërsinë e Haxhi Pierës”, tha me vete Liza. “Ndërkohë, sa shumë që i ngjan mjekut, o Zot. Po ai ballë, po ata sy.”

Çfarë mund të bënin tjetër të gjithë ata që u ra fati të jetonin në një qytet të vogël, të përgjumur? Shtrengojnë radhët rreth disa përkujdesjeve, mburrjeve dhe bujarive, që konsiderohen si të mirëqena, dhe me to mbushin jetën e tyre. Festa e përvitshme shkollore, çmimet e trojeve, përkujdesja për qepjen e rrobave të reja për çdo stinë, gara rreth shumëllojshmërisë së asortimenteve në çdo pritje, lojërat me letra, fushata e mbledhjes së ndihmave për të varfrit, manovrat komplekse për rregullimin e vajzave, që presin të ulura në piano, duke luajtur përsëri e përsëri të njëjtën muzikë melankolike të Shopenit. Çfarë të bëjnë? Pa to, pa besimin fatlum të tyre në qëndrueshmërinë e kësaj

mënyre konvencionale dhe rudimentare jetese, kishte rrezik të humbitnin vetë qenien e tyre, të shkërmoqeshin brenda asaj shkretie. Kështu që rehatohen, për bukuri rehatohen, brenda kuadrin modest të traditës, ku çdo prirje e njeriut, do të gjejë, më në fund, një mënyrë të kufizohet e të bjerë në qetësi. Madje edhe ata që nuk i mban vendi, ata që torturohen nga nevoja për të dalluar nga të tjerët, do të gjejnë te ndonjë trill i parrezikshëm iluzionin e një misioni apo dhe iluzionin e unikalitetit të vetes së tyre dhe do të ngjiten si guaskat, njëri pas teozofisë, tjetri pas aktiviteteve bamirëse, një i tretë te rritja e racave të rralla të qenve, që është shumë e kushtueshme, ndërsa të tjerë vendosin të përçmojnë gjithçka.

Zonja Evllalia gjeti dy pika mbështetjeje, që do ta mbanin një kokë më lart turmës - prejardhjen e saj fisnike që kishte si simbol shtëpinë e saj të madhe, dhe koleksionin e saj të pasur prej bimësh dhe lulësh të rralla, të cilat i siguronin vendin e parë midis gjithë adhuruesve të florës në të gjithë ishullin, pa përjashtuar këtu edhe disa zonja angleze të shoqërisë së lartë, të cilat ishin të fiksuara për sa i përkiste kësaj çështjeje.

Shtëpia ishte ndërtuar prej Haxhi Pierës, që nga koha kur ai ishte fuqiplotë. Me ambientet e bollshme dhe mbresëlënëse, me dhomat, odat dhe oborrin e brendshëm të shtruar me pllaka, me stallat, hangarët, depot, derën e rëndë prej lisi të oborrit, ajo ruante brenda heshtjes së sotme, kujtimet e kohëve të bukura të së shkuarës, kur oborri gumëzhinte nga shërbëtorët dhe bujqit, dhe gjatë gjithë ditës nuk pushonin vajtje-ardhjet e karrocave dhe kafshëve të ngarkesës. Iu dha si pajë Evllalisë, si e vetmja pjesë që i përkiste nga prona

prindërore, pasi pjesa tjetër i kaloi e gjitha dy vëllezërve të saj, që do të vazhdonin të mbanin emrin e familjes. Kjo ishte dëshira e Haxhi Pierës dhe Evllalia e gjykoi si të drejtë.

Një gjelbërim i dendur kishte pushtuar tani oborrin, hajatat me harqe, tarracën në katin e sipërm, duke i dhënë një pamje të veçantë në formën e një ansambli, që u shndërrua në një ambient të freskët, plot me hije dhe gjethnaja të formave të ndryshme dhe në të gjitha nuancat e së gjelbrës, me disa degëzime të pakta në të verdhë, portokalli, të kuqe dhe rozë, sa për t'i dhënë paksa ngrohtësi. Fikuse, lloje të ndryshme palmash, begonja, zambakë të formave e ngjyrave të ndryshme, trëndafila të ndryshëm, dhe shumë bimë të tjera me emra ekzotikë, që nga ato të zakonshmet në sasi të madhe, me gjethet e mëdha të tendosura, dhe deri tek ato më delikatet.

Kujtimet e kohëve të shkuara, të pashlyera, përgjonin gjithandej, në harmoni me atë qetësi gjelbëruese.

Në dhomën e ndenjjes, veshja prej stofi ngjyrëvishnje e kolltukëve dhe perdet janë zbardhur, dhe kanë marrë një nuancë si të verës së prishur. Pasqyra e madhe veneciane, pas sipërfaqes së saj të zbehtë dhe me njolla, fsheh në thellësi plot mistere. Përballë saj, në një pikturë të madhe me sfond të errët, me kornizë të lyer me ar, dallohet një femër nudo me linja të përkryera, në një qëndrim melankolik konvencional, duke mbajtur në gishtërinjtë e saj të trëndafiltë, një kafkë elegante të vdekuri. Mbi një tavolinë të vogël, dy zonja prej bronzi, të bëshme dhe gjysmë të zhveshura, simbolizim i panteonit intelektualist të shekullit të kaluar, mbështeten indiferente mbi një orë që i kanë ndalur akrepat, dhe duke

mos gjetur mënyrë tjetër për të treguar identitetin e tyre - Rregulli dhe Saktësia - e kanë të skalitur atë në frëngjisht, secila nën këmbët e saj të zhveshura.

- Ka studiuar për pikturë, - tha Marieta.

- Për pikturë?! - ia bëri e çuditur zonja Evllalia. - Të jesh piktor nuk është profesion. Dhe nga ç'familje rrjedh?

- E quajnë Panos Armanis. I ati ishte rrobaqepës në Nikozi, - iu përgjigj Marieta në një mënyrë të prerë, që ia priste rrugën çdo diskutimi.

Zonja Evllalia e kuptoi se nuk i mbetej gjë tjetër përveçse të jepte pëlqimin e saj formal dhe të panevojshëm. U mbështoll me madhështi në vellon e pritshmërive të saj të humbura dhe heshti për njëfarë kohe me kokën të ulur.

- Përderisa e ke vendosur, çfarë mund të bëj unë, - tha me gjysmë zëri, më në fund.

U ngrit nga kolltuku, iu afrua *jardinière*-s që ndodhej në mes të dhomës e ngarkuar me saks të mbjella me alokazia, këputi me kujdes tri gjethe që ishin vyshkur, dhe shtoi:

- Por nuk është martesa që kisha ëndërruar për ty, bija ime.

Marieta qëndronte përpara dritares dhe vështronte jashtë. Ishte e zemëruar, pa dashur, me pamjen melodramatike të së ëmës, por u përmbajt duke menduar se zemërimi i saj ishte egoist dhe i padrejtë.

U kthye nga e ëma dhe i foli me një zë të ëmbël.

- Është njeri me zemër dhe me vlera, nënë. Kur ta njohësh, do të mbetesh e kënaqur, jam e sigurt për këtë.

Zonja Evllalia hapi krahët e emocionuar dhe Marieta iu fut në prehër që të mos e mërziste.

Fari në hyrje të portit vigjilon në vetmi në mes të errësirës së natës dhe meditimet e tij shndërrohen në një rreth lodrimesh ujore drite, që e bëjnë të ndjeshëm ngazëllimin e padukshëm të detit. Në det të hapur, në mes të pasigurisë që ndjell errësira, feneri përcjell me dritën e tij siguri, si një pikë e shndritshme që shpërndan mbi ujërat blu e të errëta, që mbledh dhe shpërndan pareshtur, një tufë të paqëndrueshme fosfoeshente.

Figura të vogla të shndritshme të pranishme. Flakë vullneti me përmasa të papërfillshme, që i kundërvihen ftesës së ëmbël të gjumit.

Dritarja e ndriçuar në katin e sipërm, mbeti edhe sot duke vigjiluar mbi lagjen e mbuluar nga errësira e thellë.

Një dhomëz me muret e saj të mbushura me libra të vendosur nëpër rafte, dhe në krah të dritares, tavolina e punës. Tavolina e doktorit. Qelia e tij, siç e quante ai vetë. Librat e tij të dashur. Jo ato vëllimet e trasha, me kapak lëkure, që përmbajnë brenda tyre dijet e mjekëve; ato janë në bibliotekat e zyrës së tij të madhe në katin përdhes. Në heshtjen e këtyre librave këtu, jetojnë zëra të një lloji tjetër: poetë, prozatorë, mendimtarë, vendas dhe të huaj, që nga këngëtari i parë i verbër dhe deri tek ata të fillimshekullit tonë.

Gjithçka ka mbetur ashtu siç i la doktori. Madje edhe korniza e vogël prej argjendi me fotografinë e Marietës, nxënëse në gjimnaz, mbi tavolinën e tij. Marieta e sotme, ulur përballë saj, nuk e vë re, pasi është e përqendruar tërësisht mbi librin që lexon.

Kohët e fundit i është përkushtuar përpjekjeve për të sqaruar, duke iu referuar shkaqeve bazë, probleme të aktualitetit që ndikojnë fort mbi qenien e saj. Me lapsin që mban në dorë, heq një vijë pingule në hapësirën anash fletës, ngre kokën nga libri dhe vështron në boshllëk. Mendja e saj flatron. Ashtu është. Do t'ia ndryshojmë faqen kësaj bote.

Liza bie vonë për të fjetur, një zakon që i ka mbetur nga e kaluara.

Pastroi lokalin para se ta mbyllte, i kaloi një dorë shtëpisë dhe u ul në krah të tavolinës, ku kishte vendosur përtokë një kanistër të vogël me pak rroba që i kishte mbledhur nga litari ku i kishte nderur dhe që mbanin erë të mirë. Fshiu syzet me një copë të bardhë, që mori nga kanistra, dhe filloi të kontrollojë rrobat një për një, duke i lënë mënjanë ato që duheshin arnuar. Po e bënte këtë punë pa u nxituar. Thua se kjo punë nuk ishte një qëllim në vetvete, por vetëm një mënyrë për t'u gjetur punë duarve të saj në momentin kur mendja, e dehur nga aroma që lëshonte për të dhe vetëm për të çdo gjë brenda kësaj shtëpie, udhëtonte drejt së shkuarës.

Nuk ishte një ëndërrim nostalgjik. Nuk kishte të bënte aspak me atë përkushtim të plogët për gjërat e së shkuarës, i cili i fishk njerëzit e ndjeshëm. Jo, jo. Liza shkelte fort dhe qëndrueshëm mbi dhé. Nuk ishin pra, meditime melankolike që e kaplonin gjatë atyre orëve të qeta të natës, tek gjendej në qerthullin e kujtimeve të viteve të vrullshme të rinisë së saj. Ishin të bukura orët e natës, ishin të mira dhe të shoqërueshme. I dukej sikur kujtimet ishin të pranishme

aty, të gjalla, dhe Liza u rikthehej dhe i përjetonte në mënyrë të natyrshme, me po atë natyrshmëri që i kishte jetuar për herë të parë momentet e atij realiteti.

Dy afishe me ngjyra, varur në mur, vazhdonin të trumbetonin, me zërat e tyre të humbur, programin që do të paraqiste - para sa vitesh? - në Stamboll, në Aleksandri, në Izmir, trupa e estradës *Rozalia Mane*. Hedhur mbi jastëkët e divanit, një shall në ngjyrë të kuqe të ndezur, qëndisur me filigran prej ari, me thekë të gjatë, ngjan me një zog ekzotik me krahë të hapur, duke kënduar në mënyrë të çuditshme, ndërsa nga muri përballë i përgjigjet një freskore e madhe e hapur prej pendësh të bardha struci, të cilat me kalimin e kohës morën ngjyrën e fildishit të vjetruar. Nga fotografitë e vendosura në kornizë, që ndodhen kudo dhe plotësojnë pamjen e një dhomëze ku vishen aktorët, dallohet një foto e madhe mbi komo, ku shfaqet një Lizë në moshë të re, veshur me kostum ngjyrë të errët, me fundin deri te gjuri, me çorape ngjyrë të çelët dhe një kapelë të vogël stil *tok*, prej stofi të leshtë që i mbulonte flokët dhe i jepte pamjen e një rioshi djallëzisht tërheqës, fytyrës së saj të vogël dhe të bukur, me sytë e zinj si bajame dhe buzët provokuese, të hapura përgjysmë prej një buzëqeshjeje çapکہene. Këmbët e saj përshkruajnë një lëvizje prej valltareje, ndërsa në dorën e djathtë mban lart një bastun të vogël. Ishte sukseesi i saj i madh, roli i saj më i dashur.

*Unë jam gruaja moderne
Që do të tymos
Dhe do të votoj
Çdonjëra prej nesh vlen sa për dhjetë
Dhe për burrat... nuk jap asnjë lek.*

Nga të gjitha gjërat e saj, që u shpërndanë në çdo drejtim nga frynte era, mbetën vetëm këto të paktat, për t' i kujtuar një periudhë triumfesh, luksi dhe shpenzimesh të tepërta. Mbetën vetëm këto, dhe në sirtarin e komosë, një tufë copash të prera nga gazetatat, të zverdhura nga koha. Në po atë sirtar, poshtë rrobave të stivuara me shumë kujdes, një kuti e vogël ngjyrëvishnje, me astar prej mëndafshi të bardhë dhe mbi të shkëlqen një rubin i vendosur me shumë art mbi një unazë prej floriri. Liza e hapte rrallë këtë kuti. Por e donte dhe e sillte shpesh nëpër mend stolinë e fundit që i kishte mbetur.

Hoqi syzet, fërkoi sytë e saj të lodhur, dhe filloi të përgatitet për t' u shtrirë.

Më vonë, para se të flinte, fiku dritën, hapi dritaren dhe u mbështet mbi parvaz.

Mbrapa jaseminit, që zbukuronte oborrin dhe lëshonte një aromë të këndshme, shikonte diagonalisht një pjesë të sheshit të vogël dhe më në thellësi, format e errëta të shtëpive. Mbi çatitë e tyre të ulëta, në thellësi, dallohej dritarja e ndriçuar e Marietës që sikur ia bënte me shenjë, një shenjë fitoreje brenda asaj errësire.

- Prapë do ta gdhijë ajo sonte, - mermëriti. Ndjeu ta përshkonte një valë dashurie e dhembshurie për Marietën, që kishte mbryjtur brenda saj nga kuintesenca e vetvetes.

Po rrinte te dera e dyqanit dhe i pa kur dolën nga rrugica e përshkuan sheshin duke biseduar. E panë edhe ata, Marieta i tha diçka mikut të saj dhe u kthyen e ecën drejt saj. Kur arritën, Liza u ngrit dhe Marieta, duke e zënë burrin prej dore, i tha:

- Zonja Liza, t'ju prezantoj me Panon.

Duhej të ishte rreth dy vjet më i madh se Marieta. Shtat mesatar, supe katrore që tregonin temperament të fortë, por zbehtësia e fytyrës, tiparet e mprehta dhe një shkëlqim që vinte nga thellësia e syve të tij ngjyrë gri në bojëqielli, flisnin për një njeri që sapo kishte filluar të merrte veten pas një sprove të vështirë. Xhaketa e gjerë sportive që kishte veshur, kollarja ngjyrëvjollcë lidhur pa kujdes, flokët biondë të shpupuritur, mënyra me të cilën e vështronte tjetrin drejt e në sy, i jepnin fizionomisë së tij një karakter përzemërsie të natyrshme, të kundërt me shprehjen e përqendruar që kishte fytyra e Marietës.

Ia zgjati dorën Lizës duke buzëqeshur.

Liza e vlerësoi si simpatik, por jo dhe aq të denjë për një vajzë si Marieta.

Nuk do të uleshin për të marrë diçka? Jo, e falënderojnë, se po i priste dajë Irakliu. Një herë tjetër do të vinin enkas për të.

Liza ia mbajti dorën Marietës në dy pëllëmbët e saj.

- Ju uroj jetë të gjatë e lumturi.

Marieta dukej e lumtur.

Përpara kishës së Shën Mamas takuan teze Elpiniqin. Panos i erdhi përsëri nëpër mend pamja e dhomës së saj të

ndenjjes, ku lënësja plakë e frikësuar, e ulur në një kolltuk lëkundës, kultivonte sëmundjet e saj imagjinare, midis fotografive të të afërmeve që ishin gjallë dhe që i kishte rreshtuar mbi tavolinë, dhe fotografive të atyre që kishin vdekur, të cilat i kishte varur në murin përballë tavolinës.

Sapo i pa, teze Elpiniqi lëshoi disa pasthirrma therëse për këtë surprizë të gëzueshme, dhe këmbëngulte t'i puthte përsëri me çdo kusht në mes të rrugës, ata, fëmijët e saj, çiftin e bërë për njëri-tjetrin.

Po. Kishte ardhur të ndizte një qiri për hir të shenjtit, *ndihmona o Zot*, dhe do të shkonte në shtëpi për t'u ndërruar, sepse u djersit. "Të fala Evllalisë dhe do të vij një nga këto ditë për ta uruar". Dhe Panoja të mos harronte se asaj i duhej patjetër një fotografi e tij. I premtoi, apo nuk ishte kështu? A nuk do të dilnin në fotografi ditën e dasmës? Ha-ha-ha...

Dhe vazhdoi rrugën me hapa të vegjël e të shpejtë.

- Si thua, sa vjeç është? - pyeti Marieta.

- Rreth të gjashtëdhjetave?

- Shtatëdhjetë e ca...

- Nuk më besohet!

- Nënë time e sheh ende si kushërirën e saj të vogël.

Qëkur fillova të njoh botën, kështu e mbaj mend, duke u ankuar vazhdimisht, e duke thënë se është në buzë të varrit.

Rrugës poshtë pishëzave të parkut, i arriti zoti Lukia, ngadalësoi hapin dhe e vazhduan rrugën së bashku. Edhe ai po shkonte në klub.

- Si t'u duk qyteti ynë i vogël, zoti Armani? - pyeti dhe përgjigjen e dha po vetë. - Provincë, apo jo? Tjetër gjë është Athina! Kur isha student në Juridik..., - dhe me bastunin e tij bëri një lëvizje, sikur po rrihte vezë, për të treguar se sa shumë e kishte shijuar Athinën në periudhën që ishte student në Juridik. Pastaj nxori nga xhepi një shami të madhe me fileto bojëqielli, ngriti kapelën republikë dhe fshiu kokën tullace.

- Ç'mendoni të bëni pasi të martoheni, zoti Armani?

Panoja nuk iu përgjigj. Kishin arritur ndërkohë te klubi, dhe disa, që ishin ulur jashtë, u ngritën për t'i uruar mirëseardhjen të huajit.

Dajë Irakliu i priste te salla e leximit, duke pirë konjak. Poltroni mezi e nxinte trupin e tij të bëshëm.

- Mirë se erdhët! - u tha ai. Dhe pa u ngritur, zgjati dorën dhe u tregoi dy kolltukë që ishin afër tij.

- Do të marrësh një konjak, Pano? - pyeti me një familjaritet të tillë, saqë e habiti Panon.

- Ju faleminderit. Preferoj pak vermut.

- Andrea, një vermut, dhe një konjak tjetër për mua! - i thirri kamerierit. - Po ti, Marieta, çfarë do të marrësh?

- Një limonadë, - iu përgjigj Marieta dhe vështronte Panon me një buzëqeshje pothuajse të padukshme.

Dajë Irakliu, që e konsideronte veten kryetar të familjes, kishte pikëpamjet e tij për pozicionin e gruas në shoqëri dhe asnjëherë nuk mundi ta kapërdinte vendimin e doktorit për ta dërguar Marietën për studime, madje për mjekësi. Kështu që do ta konsideronte një sfidë të papranueshme nëse mbesa

e tij kërkonte tani të merrte një pije bashkë me të në klub. Lëre, kush merrej me të.

Ditën e dytë pas mbërritjes së Panos, Marieta, për t'i bërë qejfin së ëmës, e mori dhe shkuan për vizitë te dajë Irakliu. Ai mbajti kundrejt çiftit një qëndrim të rezervuar, por nuk bëri asnjë pyetje. Më mjafton të tregoni respektin e duhur, thoshte me qëndrimin e tij, sa për të tjerat, nuk përzihem në çështjet tuaja. Dhe priti të kalonte dyfishi i kohës, katër ditë, para se t'ua kthente vizitën një mëngjes - ishte duke kaluar këtej, siç tha - dhe t'i ftonte për drekë në shtëpinë e tij të nesërmen.

- Ejani të më takoni në klub rreth orës njëmbëdhjetë dhe të shkojmë së bashku.

Ishte zyrtarizimi nga ana e tij i fejesës së mbesës, dhe me këtë rast e gjykoji si të drejtë të tregohej më i ngrohtë dhe më i afërt e të mos i drejtohej më Panos, zoti Armani.

Fliste pa e vështruar bashkëbiseduesin në fytyrë, shikonte vetëm anash me ata sytë e tij të vegjël shumë dinakë, të rrethuar me lëkurë të dhjamosur.

- Ty, që je piktor, si t'u duk piktura që ka në dhomën e ndenjjes Evllalia? Një art i mrekullueshëm, apo jo? Dhe me ç'përmbajtje! E ku të gjesh vepra të tilla sot. E solli plaku nga Marseja, një herë që vajti vetë deri aty me një ngarkesë me fshikëza krimbi mëndafshi.

Panoja heshtte, kishte filluar të humbiste durimin.

Pas pak u mblodhën rreth tyre disa prej personave më të rëndësishëm të atij komuniteti të vogël, të gjithë sa u ndodhën në atë moment në klub. Mjeku Kallojani, me

një zinxhir prej floriri dhe fytyrë të kuqe prej arkondi të ushqyer mirë, që iu drejtua Marietës “e dashur kolege” me një mënyrë sikur e thoshte me shaka. Zoti Papazinoviu, një plakush trupvogël dhe tullac, me një qafore të fortë. Nënkyetari i bashkisë, që numëronte kohën, me kërcitjet tak, tak, të rruazave prej qelibari të tespiheve të tij. Zoti Lukias, dhe dy-tre zotërinj të tjerë.

Pa lëvizur nga vendi, vetëm me një tentativë lëvizjeje gjoja për t’u ngritur, dajë Irakliu bënte çdo herë prezantimet: dhëndri ynë... piktor i mrekullueshëm. Të tjerët përgjigjeshin se gëzoheshin shumë dhe vështrojnë me kërshtëri Panon, sikur e peshonin se sa vlente.

U diskutua për pikturën dhe për artin në përgjithësi, dhe zoti Papazinoviu, duke ngritur dorën e tij, me dy gishtërinj të bashkuar, thua se po betohej, bëri një ndërhyrje të rëndësishme në lidhje me artin, të ndërthurur me fenë dhe virtytin, sikur ishin entitete të padiskutueshme, që i shkonin për shtat atij. Secili tha mendimin e tij. Dhe Panoja gjatë gjithë kohës shqetësohej, se mos i kërkonin edhe atij të shfaqte mendimin e vet. Çfarë t’u thoshte? Për fat, nuk e pyeti asnjëri. Dhe biseda gradualisht ndërroi drejtim derisa përfundoi te problemet dhe interesat e tyre, dhe atëherë e kuptuan se po shkelnin në terren të njohur për ta.

Ora ishte katër kur u larguan nga shtëpia e Irakliut.

Panoja dukej i lodhur dhe pa humor.

- U mërzite? - e pyeti Marieta.

Ai i buzëqeshi dhe e kapi nga krahu.

- Ndihem pak si peshku pa ujë, - iu përgjigj.

- Durim. Nuk mund të mos ia jepnim këtë kënaqësi nënës sime. Me këto gjëra do të ngushëllohet më vonë, pasi të ngelet përsëri vetëm. E shkreta, u jep kaq rëndësi formaliteteve.

- E kuptoj, Marieta. Ke të drejtë.

Ecën për pak të heshtur në qetësinë e pasdites.

- Në Nikozi do të jetë ndryshe. Do të punojmë, - tha, më në fund, Marieta. - Njerëzit e tu nuk do të kenë kaq paragjykime.

- Cilët njerëz të mi? - qeshi Panoja. - Ti e di, nuk e kam prejardhjen nga ndonjë fis i dëgjuar. Nëna ime është një grua e thjeshtë, që vetëm dashuri do të na falë.

Nëpër rrugicat ku kalonin nuk kishte këmbë njeriu. Një zagushi e mbyste qytetin dhe hijet e shtëpive sapo kishin filluar të zgjateshin. Duke ecur shkelnin mbi hijet e trupave të tyre. Mbrapa një gardhi u dëgjua kërritja e një derri.

Kur arritën te qoshja, panë dajë Tason që po zbriste nga rrugica në krah. Kishte veshur një këmishë ngjyrë të çelët, xhaketë linoje, pantallona të holla, dhe në xhepin e xhaketës kishte një lule të madhe jasemini, që kundërmonte erë të mirë. Flokët e bardhë dhe me onde, fytyra e mprehtë, i jepnin pamjes së tij një finesë, paksa si intelektuale, por hunda e skuqur dhe si e varrë lie, tregonin që ishte i dhënë pas pijes. Në ndryshim nga Irakliu, ishte i gjatë, i hollë dhe i zhdërvjellë për moshën që kishte. U gëzua, me të vërtetë, që i takoi.

- E hoqët qafe dhe atë ceremoni? - i pyeti duke qeshur.

- Dukeni të rënduar nga të ngrënët e nga të pirët. Apo mos jeni të tejfryrë nga zyrtarizmat?

U fut mes tyre dhe u futi të dyve krahun.

- Ejani me mua t'ju qeras me një kafe te lokali i Lizës, që të vini përsëri në qejf.

Dajë Tasoja nuk ishte martuar. Kishte udhëtuar shumë kur ishte i ri dhe tani jetonte i vetëm. Shumë rrallë shkonte në klub apo te kafeneja. Të tjerët e konsideronin ekscentrik dhe bënë thashetheme për të, për faktin që nuk merrte seriozisht asgjë prej atyre që ata i preokuponin shumë.

Por Panoja, që në bisedat e para që kishte shkëmbyer me të në shtëpinë e Evllalisë, ku vinte dhe i takonte përditë, e kuptoi se këtij njeriu të bredhur, që i shmangej tundimit për t'u dukur, nuk i mungonte as kultura dhe as gjykimi i shëndoshë.

- Do të pimë kafe në pijetore? - u habit Panoja.

- I dashur, Liza është një pronare taverne e kulturuar.

Zonja Evllalia nxori pengesa, por, më në fund, dha pëlqimin e saj që dasma të bëhej në një rreth shumë të ngushtë, pa ftesa, pa pritje, pasi siguroi premtimin se do të ishte e lirë të dërgonte njoftimet pas dasmës, sipas gjykimit të saj. Në shoqërinë e lartë, kjo gjë bëhet edhe sot.

Vënia e kurorës do të bëhej në manastirin e profetit Ilia, ku do të shkonin me tri automjete, çifti, zonja Evllalia, familja e dajë Irakliut, dajë Tasoja dhe teze Elpiniqi, e cila edhe e kishte pagëzuar Marietën. Nga ana e Panos do të vinin e ëma dhe i vëllai nga Nikozia. Igumeni lajmëroi se do ta celebronte personalisht këtë martesë.

- Kam simpati për nënën tënde, - tha Panoja. - Ka karakter të fortë, e aftë për të jetuar e vetme në botën e saj imagjinare. Thellë-thellë, i ngjan. Keni të përbashkët vullnetin për të parë pasojën.

Marieta buzëqeshi.

- Po unë nuk jetoj në një botë imagjinare.

- Kjo është diçka tjetër, - i tha Panoja, dhe duke ngritur gotën, u drejtua nga zonja Liza. - Për shëndetin tuaj, zonja Liza.

- Për shëndetin tënd, zonja Liza, - uroi edhe Marieta. - Po afrohu pra dhe na bëj pak shoqëri.

U kishte shërbyer uzo dhe po përgatiste mezet pas banakut.

Ishte ditë e premtë, pothuajse drekë. Dasma do të bëhej të dielën.

Solli tabakanë me mezet dhe u ul afër tyre. - Për shëndetin tuaj. Jetë të lumtur, - i uroi ajo e emocionuar.

Donte të bënte një urim për planet e tyre në të ardhmen, por nuk dinte sesi ta bënte. Thua se e dinte se çfarë po planifikonin? Por, ndërkohë, parandjenja e saj nuk e gënjente. E kuptonte që mezi prisnin të hipnin përsëri në anije dhe të ngrinin velat.

- Dhe u realizoftë qëllimi juaj, - shtoi ajo.

Marieta me Panon u panë sy më sy.

“Grua e zgjuar”, tha me vete Panoja.

Trokitën gotat.

Kur po mbyllte dyqanin në darkë vonë, Liza ktheu kokën dhe vështroi lart. Dritarja e tyre sonte nuk ishte e ndriçuar. Natyrisht. Nesër kanë dasmën dhe duhet të përgatiten.

Bëri punët e shtëpisë, hëngri darkë, por gjatë gjithë kohës, mendja i rrinte në një vend.

Hapi dollapin, nxori një fustan blu prej mëndafshi, e kontrolloi me imtësi duke e mbajtur të tendosur me të dyja duart dhe vendosi se duhej të rregullonte pak jakën para se ta hekuroste, që ta kishte gati. Nesër do të shkonte të uronte çiftin e ri. U ul, vuri syzet dhe kaloi perin në gjilpërë. Por mendja nuk i gjente qetësi.

Brenda saj llamburiste një dritë ngjyrë floriri, duke u alternuar me hijet, përreth figurave që nuk mund të konceptohen. Ajo shprehje disi e largët dhe e krekosur në fytyrën e Marietës, që kishte në një mënyrë të pashpjegueshme, por të sigurt, kuptimin e një premtimi. Ajo pamje e qetë, e mirë dhe e pikëlluar e doktorit. Ata sy të pafajshëm fëmijërorë të Haritos. Ajo fytyrë e freskët dhe besnike e Panos. Pa qenë në gjendje për të dalluar të gjallët nga të vdekurit, veçse kur kërkonin së bashku, dhe njëkohësisht veçmas, rrugicën e fshehtë që të çonte matanë ujërave moçalore. Dhe veten e saj të lidhur pas tyre me prangat e një shprese të përbashkët.

Nga ana e detit u dëgjua një angullimë e zgjatur. Një anije transporti, nga ato që vijnë rrallë dhe ankorohen te porti i vogël, po nisej e ngarkuar me çifibanozë.

Liza buzëqeshi. E gjeti! E gjeti dhuratën e saj, që i përshtatej vajzës së Kanelit. Pse? Duarbosh do të shkonte të uronte Marietën që po martohet?

U ngrit, vajti te komoja, hapi sirtarin dhe nxori poshtë dengut të rrobave, kutinë e vogël ngjyrëvishnje. E hapi

dhe qëndroi për shumë kohë duke vështruar gurin rubin që shkëlqente nën rrezet e dritës. Pastaj mbylli kutinë e vogël, e vendosi në cepin e tavolinës dhe filloi përsëri të qepte.

U qetësua. Me këtë dhuratë, kujtimi i saj do të mbetet i gjallë në mendjet e tyre. Nuk ndiente asnjë hezitim, vetëm ishte e kënaqur me vendimin që mori.

MËRZI

Mbrëmjen e lamtumirës, Zenioja, që do të largohej, ishte i heshtur. Piereti, që mendohej se sa do t'i mungonte miku i ri si dhe admiruesi i tij, ishte i emocionuar dhe recitonte vargje, me zërin e tij të thellë dhe sugjectionues.

Po shëtisnin të dy anës bregut, deti psherëtinte i lumtur, dhe ai dëgjonte brenda vetes dhe recitonte.

Në një moment, e kapi mikun e tij për krahu, dhe i tha: - Mos e vrit mendjen. Gjithë puna është ta mbash veten tënde të vërtetë, të veçuar nga vetja jote tjetër, që është një lodër e rrethanave.

Por Zenioja vazhdonte të heshtte.

Kaluan muaj. Piereti mori letër nga miku i tij, ku i shkruante se kishte filluar punë në një restorant në Sidnei.

Dhe atëherë imagjinoi qytetin e madh dhe të zhurmshëm, të ulet e të ngrihet si një anije ekzotike që lundron nëpër oqeanet e Konradit, të mbushur me misteret e lloj-lloj njerëzve. Përfytyroi edhe ndjeshmërinë e mikut të tij, që

tashmë harmonizohej me nocione të tjera, teksa kujtonte me nostalgji “brigjet e gjelbra të atdheut”.

Piereti është një krijesë e ndjeshme, dhe me fantazinë e tij mund të krijojë emocionin, që buron nga kushte që nuk i pa nga afër, meqë ai vetë mbeti në ishull, ku rrethanat ia sollën jetën mbarë, dhe madje, që në moshën njëzetetëvjeçare, u emërua shkrues i nivelit të parë në kadastër. Sado që dikush, duke u nisur nga superioriteti intelektual, mund të vendosë në plan të dytë anën praktike të jetës së tij, nuk e vendos kaq lehtë të largohet drejt së panjohurës ndjellëse, vetëm e vetëm për aventurë, në kushtet kur është i sistemuar në një vend të përhershëm pune dhe me perspektivë, dhe mund të llogarisë me qetësi përparësitë që i ofron një martesë e mirë, të cilën do ta vendosë vetë kur të vijë momenti.

Kështu që rrugëdaljen e gjen duke mbajtur anën më të thellë të vetes së tij, veçmas nga përditshmëria e të qenët nëpunës dhe nga gjërat e parëndësishme që e rrethojnë. Duke mbajtur si koracë pozën e intelektualitetit të tij, ndihet i përzgjedhur dhe shpirtërisht i veçuar, megjithëse mban marrëdhënie të shkëlqyera me njerëzit rreth tij, sepse zgjodhi të jetë i sjellshëm, të shijojë qetësinë e tij dhe të gëzojë respektin e tyre.

“Nëse e kalojnë jetën duke u marrë me gjëra të vogla dhe nxisin pa mbarim armiqësi dhe dyshime midis tyre, - mendonte ai, - kjo ndodh ngaqë u çmësuan të shikojnë drejt qiellit.”

Madje disa u përpoqën të mbjellin dyshime edhe për tekat intelektuale të Pieretit. Por kur u siguruan se nuk kishin arsye për t’u shqetësuar, këto teka iu dukën pothuajse simpatike dhe të duhurat. Madje pak ditë më parë, kur dha

në klubin *Areti* një tjetër leksion me temë poezinë, erdhi për ta dëgjuar e gjithë elita e qytetit të vogël, zonja dhe zotërinj, për ta dëgjuar me vëmendjen që i shkon për shtat personave që dinë ta vlerësojnë jetën intelektuale. Thellë-thellë madje, sikur i detyroheshin njëfarë mirënjohjeje për këtë vetëvlerësim që u fali.

Ah! Sikur të mos ekzistonte ai shejtani i vogël, që herë pas here zgjohet brenda tij e shkulet së qeshuri i paudhi, dhe e munxos. Apo disa momente të zymta, kur e kaplon mërzia dhe ndien togën e tij të shndritshme të tretet dhe ta lërë krejt lakuriq përballë vetes së tij, me ndjesinë e hidhur se më kot po mundohet të fshihet.

Këto ndërkohë janë gjëra të koklavitura. Duhet vetëpërmbytje përballë shtysave që vijnë prej lodhjes. Por a mund të bëhet ai, skllav i shqetësimeve që kanë ngritur pusi brenda vetes së tij? Po pastaj? A mund ta bësh pjellor intelektin tënd kur përballësh me një gjendje pasigurie ekonomike? Dhe përveç kësaj, mos ndoshta, në jetën e tij të sistemuar dhe komode, i mungojnë librat dhe pavarësia e tij medituese? Po nëse përditshmëria e rëndomtë në “këtë cep të vogël” nuk i korrespondon shpërthimeve shpirtërore, a është i sigurt se diku tjetër i përgjigjet? Jo, nuk e di, Piereti nuk e qartësoi dot këtë, sado që e shtrydhi mendjen herë pas here. Kështu që, duke pritur gjithnjë shtysën tjetër, është në kërkim të vetes së tij në rolin e pelegrinit të heshtur të së bukurës.

Dhe është kaq i bukur ky vend, saqë shpalos palëvizshmërinë e vet në këtë cep të ishullit. Qyteti i vogël qëndron i larë në dritë majë asaj lartësie dhe sodit detin e kaltër, dhe prej aty e deri poshtë në breg, te porti i vogël,

fillojnë e dallohen bahçe me lule, shtëpi dhe rrënoja të një lavdie të lashtë.

Kultivon në këtë mënyrë meditimin e tij që të frymëzohet nga bukuria e universit dhe mbyllet në guaskën e përkujdesjes që të shqyrtojë ecurinë e tij të brendshme, meqenëse përreth tij nuk ndodh asgjë e denjë për t'u shënuar ose diçka që mund ta prishë këtë gjendje mërzie, përveç disa ndodhive të parëndësishme, siç ishte pardje për shembull, mbërritja e një anijeje tregtare holandeze në port.

Si zakonisht, kishte zbritur pasdite për të bërë shëtitjen e tij.

Rrugët në tregun e qytetit ishin të mbushura me mbeturina rrushi të shkelur me këmbë, që të ngjiteshin në këpucë. Në mëngjes kishte pasur një lëvizje të pazakontë kamionësh ,që zbrisnin nga fshatrat ku kultivohet rrushi, të ngarkuar me rrush, dhe fshatarësh që e flaknin atë në rrugë, për të shprehur në këtë mënyrë protestën e tyre për çmimet e ulëta që u ofronin industritë e prodhimit të pijeve, që ishin marrë vesh paraprakisht mes tyre.

Tregtarët dhe disa kalimtarë qëndronin në dyert e dyqaneve dhe diskutonin për ngjarjen. Disa ishin pro, dhe disa kundër.

“E ç’do të fitojnë nga gjithë kjo zallamahi?”, mendoi Piereti. “Se mos duke flakur rrushin në rrugë dhe duke bërtitur, do të shtohet kërkesa jashtë shtetit për verërat tona?”

Shpejtoi hapin që të kapte perëndimin e diellit.

Shëtitja e tij e zakonshme ishte të zbriste tatëpjetë drejt portit të vogël, të ulej te lokali buzë detit dhe të shijonte

freskinë dhe diellin, që perëndonte në prehrin e detit me të gjithë madhështinë e tij flakëruese.

Por, sapo doli te vendi nga ku mund të sodiste lirshëm, iu shfaq aty poshtë vapori, që kishte hedhur spirancën në det të hapur dhe po shkruante me tymin e oxhakut në qiellin e virgjër, mesazhin që kishte sjellë prej porteve të mëdha. Zemra e Pieretit filloi të rrihte me forcë.

Maunat te porti i vogël, të çliruara prej ndryshkut që kishin zënë, ngarkonin nga anija stiva të tëra thasësh me pleh kimik dhe ndiqnin në radhë anijen e vogël me motor, e cila i tërhiqte duke gulçuar drejt skelës së konsumuar prej detit, që të shkarkonin. Porti i vogël flaku tej letargjinë e buçiste nga aktiviteti i tij i përkohshëm, dhe shpresat e tij që kishin marrë krahë.

Ra nata dhe Piereti po rrinte ende te lokali buzë detit, duke pirë uzon e tretë të tij dhe duke u bërë xheloz për anijen që shkëlqente nga dritat dhe për marinarët e saj të panjohur.

U ngrit vonë për të ikur dhe kur arriti përsëri lart, te ai vendi nga ku mund të shihte gjithçka në pëllëmbë të dorës, u kthye dhe vështroi sërish ndriçimin magjik të anijes në errësirën e natës. Pastaj, në vend që të kalonte nga klubi, siç bënte zakonisht, vajti drejt e në shtëpi.

Dhomën e kishte të rregulluar me shumë kujdes. Raftë të mbushura me libra, letra dhe shënime të vendosura me rregull mbi tavolinë, dhe përballë tavolinës së punës, varur në mur, një kopje litografie e pikturës së Belinit “Dozhi Leonardo Loredan”, që e preu dikur nga një revistë e ilustruar dhe e vuri në kornizë, ngaqë i kishte bërë përshtypje.

U ul dhe po e vështronte. E tërhiqte shumë ajo fytyrë e rreptë me sytë e futur thellë, me nofullën e poshtme të fortë

dhe të shtrënguar, me buzët e holla, që tregojnë vullnet të çeliktë, energji, dinakëri dhe ndërgjegjësimit për fuqinë dhe madhështinë e tij, simbol i së cilës është edhe uniforma e tij e pasur.

Në vijim u vu në kërkim të frymëzimit, që donte ta kishte sjellë me vete. Por nuk gjeti asgjë, veç një lëmshi shpresash të paeksploruara.

Dhe u shtri i pakënaqur për të fjetur.

PANTELICA

Banoja në një shtëpi të vjetër, ku mungesa e komoditetit kompensohej për mua nga qiraja e ulët dhe vendi piktoresk ku ndodhej. Ishte një *saraj* (shtëpi madhështore) i vjetër dykatësh, rrethuar nga shtëpitë e lagjes së të varfërve të ndërtuara së fundmi, që i merrnin frymën. Pjesa ballore, me odat e mëdha, që i kishin dritaret të mbyllura me dërrasa të mbërthyera mbi to, ishte dhënë me qira për magazinë. Në pjesën e pasme, një si krah i rrënuar formonte kënd të drejtë me pjesën kryesore të saj, dhe përbëhej nga një hapësirë përdhese me dy ambiente dhe një dhomë në kat të dytë, me shkallë të jashtme prej druri. Në ambientin përdhes banonte qiramarrësi, Mellodhia me familjen e tij, i cili më kishte dhënë mua me qira, “së bashku me mëngjesin dhe larjen”, dhomën sipër.

Pjesa e brendshme e këtij këndi të drejtë, e mbyllur nga të dyja anët e tjera me mure të larta, ishte oborr. Ishte një oborr krejt i vogël, të cilin e mbysnin ndërtesat

shumëkatëshe që lartësoheshin pas murit rrethues. Një pemë nerënxe, njëdegëshe, që lartësohej duke u përpjekur më kot të kapërcente rrethimin mbytës, si dhe teneqetë ku rriteshin borzilokë, karafila dhe lulepatate, që mezi merrnin frymë brenda në atë pus, ngjanin si një prani e zbehtë jete nën hijen e rrënojave të *sarajeve* dikur të bukura dhe të ndërtesave pa shije përreth.

Por rreth kohës së drekës, kur rrezet e dritës, duke rënë pingul arrinin deri në thellësi, deri tek oborri i vogël, ndodhte një mrekulli dhe të gjitha ato copëza të varfra bukurie, ai gjelbërim i paktë, lulet, kanarina në kafazin e saj, kurtinat shumëngjyrëshe në dritare, linjat e përkryera të *sarajeve* me dritaret me kafaze shumë të vjetra, shndrisnin nën një simfoni idilike, por me nuanca të dobëta, që më magjepste.

Ajo ishte dhe ora që zgjohesha.

Atë periudhë studioja për muzikë dhe e nxirrja bukën e gojës duke luajtur piano në orkestrën e një lokali nate. Shkoja në dhomën time për të fjetur, në kohën kur sapa fillonte të dallohej bluja e zbehtë e qiellit dhe ndieja mornica në trup, që paralajmëronin agimin e ditës së re.

Hapat e mi kumbonin çuditshëm nëpër rrugicat e fjetura. Hapja me kujdes derën e oborrit, e cila kërciste, dhe zakonisht vonohesha pak në oborr, për të tymosur një cigare duke dëgjuar zhurmën e kristaltë dhe monotone të ujit që pikonte pik, pik.

I ngjisja shkallët në majë të gishtave dhe sapa futesha në dhomë, hiqja këpucët, në mënyrë që të shkelja pa zhurmë në dërrasat e kalbura, që më ndanin nga të tjerët, të cilët flinin poshtë.

Shumë herë, para se të më zinte gjumi, dëgjoja Mellodhian dhe gruan e tij, Titikën, kur ngriheshin dhe fillonin nga punët, duke u kujdesuar ashtu si unë, të mos bënëin zhurmë. Piqnin byrekët me djathë, që i kishin përgatitur që në darkë, dhe Mellodhia do t'i vendoste ashtu siç ishin të ngrohtë në radhë, në një triçikël, dhe do të dilte duke e shtyrë, për t'i shitur nëpër rrugë sapo të agonte dita e re.

Flija mirë. Isha i ri, thurja ëndrra kur isha zgjuar dhe flija, pa parë ëndrra që do të më prishnin gjumin.

Kështu që zgjohesha pikërisht në ato momente të shkurtra, por të shndritshme, kur dielli binte mbi oborr dhe zbrisja të laja sytë në çezme, të ulesha në sofat dhe të shijoja kafenë së bashku me një byrek me djathë - mëngjesi për të cilin kishim rënë dakord - që ma sillte Titika në një tabaka dhe e mbështeste mbi një karrige. Byrekët e Mellodhias ishin me famë.

Vizitën e diellit në oborr e priste si një bekim edhe e moshuara Pantellu, e ëma e Titikës, një si gërmadhë tuhafe, që i kalonte ditët dhe netët e pambarimta, herë e shtrirë në dyshek dhe herë ulur në një stol, duke u qarë dhe duke gulçuar, duke u torturuar dhe duke torturuar Titikën, që duhej të kujdesej vazhdimisht për të, ta ushqente, ta çonte si foshnjë, nga dysheku në stol dhe nga stoli në dyshek, ta pastronte, si dhe të dëgjonte ankesat e saj pa mbarim. Më vinte keq, jo për plakën, për Titikën, që ndiqja se si nënshtrohej duke e përmbajtur veten, ndoshta ngaqë nuk donte të nxehej para një të huaji.

Sapo ndiente praninë e diellit, Pantelluja bënte si bebe e paduruar dhe nuk qetësohej derisa të shkonte Titika ta mbante dhe ta nxirrte, me hapa të ngadaltë, deri te pragu i atij ambienti përdhes me lagështirë, të merrte stolin dhe ta ulte në të, të mbështetur pas murit. Dhe sapo ndiente në trup ledhatimin e rrezeve të diellit, plaka qetësohej. Rrinte aty si e përhumur, dhe nuk ishte e vetëdijshme as për të mbledhur ato rrobat e saj si rrecka, që nganjëherë i rrëshqisnin dhe linin zbuluar trupin e saj të neveritshëm. Në ato momente ndihesha i turpëruar dhe ktheja kokën në anën tjetër.

Por ajo që më sillte në humor kur zgjohesha, ishte Pantelica, e bija e çiftit Mellodhia, një vajzë e këndshme në moshën pesëvjeçare, që cicërinte në oborr, zhgërryhej përtokë, shkelte nëpër ujëra dhe ruante momentin kur do të zbrisja nga kati i dytë, për të vrapuar drejt meje dhe për të më thënë atë “mirëdita” të veçantë për të cilën ishim marrë vesh të dy.

- Sa e bukur është jeta që bëjmë!

Qeshte fytyra e saj e vogël dhe e zbehtë, qeshnin dhe shkëlqenin sytë e saj ngjyrëgështenjë, teksa më vështronte me guxim dhe siguri në vetvete.

- Sa e bukur që është jeta jonë, vogëlushe!

Dhe i jepja karamela, për të cilat kujdesesha t’i kisha gjithmonë në xhep, për këtë qëllim.

Unë ia kisha mësuar këtë mënyrë origjinale për të më thënë mirëdita.

Pas natës së parë që kalova në dhomën e vogël të katit të dytë, kur po zbrisja gjithë qejf në oborr dhe e pashë përpara meje ashtu të gëzuar duke më buzëqeshur, i thashë:

- Sa e bukur që është jeta jonë, vogëlushja ime! - dhe i dhashë një çokolletë që rastisi të gjendej në xhepin tim.

Mëngjesin e ditës tjetër, sapo lava fytyrën dhe po fshihesha, Pantelica u shfaq para meje.

- Sa e bukur që është jeta jonë! - më thotë ajo.

Më erdhi keq që nuk e kisha parashikuar. Dhe që atë ditë, nuk harroja të mbaja diçka në xhep. Në këtë mënyrë u ligjërua përsëritësisht optimiste “mirëdita” me Pantelicën, duke na dhënë gëzim të madh të dyve.

Atë ditë, Pantelica erdhi si gjithmonë të më ofronte optimizmin e saj të pandryshueshëm dhe të pranonte ofertën e mirënjohjes sime.

“Sa e bukur që është jeta jonë! Këngë në zemrën time, fjalët e tua harabelkë.”

Plaka, e mbledhur kruspull mbi stolin e saj, gulçonte.

Nuk e kisha parë kurrë Pantelicën t’i afrohej gjyshes së saj. Ndoshta instinktivisht ndiente ndot, gjë që e mbante fëmijën larg asaj shëmtie.

Befas, plaka krakëlliti e zemëruar për të dëbuar gjelin, i cili mori guximin dhe vajti për të çukitur para këmbëve të saj.

Pantelica u kthye dhe e vështroi, pastaj rrotulloi trupin në drejtimin tim e më tha:

- Nëse do të vdesë dhe kjo, do të biem rehat.

Shtanga.

Asgjë nuk kishte ndryshuar në shprehjen e fytyrës së vogëlushes. Deri në ç'masë vallë arrinte t'i kuptonte këto fjalë të hidhura, që do t'i kishte dëgjuar të dilnin nga buzë të mërzitura! Në vrimat që i bëheshin në faqe kur qeshte, në sytë e saj të zgjuar e të qartë që shkëlqenin, pashë gjithë ashpërsinë e jetës së papërlyer.

U ngrita për të shkuar në kafenenë e lagjes, në të cilën do të gjeja ndoshta Pipion, duke pirë dhe duke na argëtuar me shakatë e tij pa kripë.

Nuk kisha dëshirë për të studiuar.

FUNDI I ZOTIT TRIKO

Nuk ka krijesë në botë, as edhe ajo më e rëndomta, që të mos ketë orët e veta poetike. Gaforrja e rërës, që e kalon jetën e saj futur në një vrimë, duke vigjiluar e duke pasur frikë, njeh edhe ajo momente lirike, kur qëndron në buzë të zgavrës e magjepsur nga prania e detit të paanë dhe merr frymë nën ritmin e pulsit të tij.

Zoti Triko e kalonte jetën, i struktur si gaforrja, brenda dyqanit të tij, vigjilent ndaj mundësive që do t'i sillnin fitime, dhe duke pasur frikë nga të gjitha llojet e rrymave, edhe ato që shkaktojnë rrufe, por më tepër nga ato që tentojnë të prishin rregullat e shoqërisë dhe qetësinë e çdo qytetari. Kishte edhe nipërit e tij, por ata nuk i kishte frikë - e përse t'i kishte frikë? - vetëm se nuk kishte simpati për ta, sepse bëheshin shkak që të mendonte vdekjen dhe të torturonte veten për të gjetur një mënyrë, që ta përpilonte testamentin e tij në një formë të tillë, që ata të mos kishin mundësi të përfitonin nga trashëgimia.

Të plakesh i pamartuar, të përballësh me mungesa dhe me mundime derisa t'i vësh punët e tua në vijë, dhe të tjerët të vijnë ta gjejnë tryezën të shtruar, vetëm e vetëm se rastisi që të lindin nipërit e tu. Për ç'arsye? Zoti Triko ishte i vendosur që t'ia linte të gjitha çka kishte një institucioni bamirësie që do të merrte emrin e tij - Ioannis P. Trikkos - në jetë të jetëve.

Veç këtij shqetësimi, ditët rridhnin si një seri kotësish të mirërregulluara, ku nuk kishte vend për asgjë tjetër veç komoditetit të tij modest dhe kënaqësisë së majmur që kishte për veten.

Ndërkohë, edhe zoti Triko kishte momente, ku nga ndonjë dritare e vogël, ajrorej ambienti i mbyllur i shpirtit të tij. Këto momente ishin gjatë mëngjesit kur hapte dyqanin, dhe derisa ndihmësi të pastronte, ai nxirrte dy karrige në trotuar dhe ulej të pinte kafënë, t'u thoshte mirëdita fqinjëve, të shijonte freskinë e mëngjesit dhe parapërgatitjet stereotipe, por gjithnjë të reja, të tregut, për të filluar një ditë të re pune.

Asfalti në rrugë ishte i porsalarë, qepenat e dyqaneve mblidheshin njëri pas tjetrit me zhurmë, ndihmësit fshinin trotuaret, njerëzit derdheshin nga rrugicat për të shkuar në punë: njerëz të kërrusur nga vitet dhe hallet, të rinj që ende nuk ishin çmësuar të ecnin me kokën lart, vajza tepër elegante, dhe ecnin me nxitim, një e nga një apo në grupe, për aty ku i priste dita e punës.

Duke shijuar freskun dhe kafënë e mëngjesit, Triko përjetonte momente humori të padjallëzuar, një si mjegullnajë ekstaze e ngrinte me kujdes lart dhe e përkundte nën shkëlqimin e një magjie të papërcaktuar. Nëse do të ishte në gjendje të sqaronte se çfarë po i ndodhte në ato

momente, ai do të thoshte: “E pra, kemi edhe ne, njerëzit e dyqaneve, shtresa e njerëzve më të zakonshëm, siç na quajnë, një moment fluturak poetik”. Por as nuk ishte në gjendje ta bënte, dhe as nuk provoi të sqaronte diçka. I gëzohej vetëm momentit, dhe qielli që shfaqej mbrapa çative, hapte krahët me dashamirësi.

Banonte në një apartament të vogël mbi dyqan (prona e patundshme ishte e tij). Flinte mirë, zgjohej shumë shpejt, ngaqë i ishte bërë shprehi që herët, dhe zbriste gjithë humor e duke lëshuar një aromë të këndshme. Edhe kjo ishte brenda “parimeve” të veta, që të kujdesej për veten dhe të vishej gjithmonë mirë, sepse paraqitja e mirë, e kombinuar me metoda sjelljeje serioze, u imponon klientëve besim dhe shkurojnë ata që do të dëshironin të bënin pazar me të, ashtu siç do të bënin pazar me çdo shitës të vogël mallrash. Çdokush humbet kohën me një klientelë të tillë. Zoti Triko interesohej të tërhiqte në dyqanin e tij vetëm shtresën e lartë të shoqërisë, dhe ishte shumë i aftë në artin e të dhënit dyqanit të tij një atmosferë aristokratike dhe etike, që u shërbenin interesave të veta. Po nga mësoi ky njeri - i cili e nisi rrugën e vet zbatuar dhe i rreckosur - që të dallojë kë duhet të përshëndesë me mirësjellje dhe t’ia përcjellë nëpunësit për t’i shërbyer, kujt do t’i shërbejë vetë personalisht dhe cilën zonjë të shoqërisë së lartë do të shoqërojë me nderime deri te dera? Është e sigurt që me këto aftësi dhe me forcën e pamposhtur të një mediokri, i përkushtuar në mënyrë këmbëngulëse kundrejt qëllimit të vetëm dhe rregullave të jetës të skalitura një herë e përgjithmonë, ia arriti qëllimit të tij dhe i forcoi rregullat e veta nëpërmjet prestigjit të padiskutueshëm të suksesit të vet. U bë zoti Triko dhe ishte e paimagjinueshme që ta thërrisje thjesht Triko.

Rrufiti një gllënjë kafe dhe kërkoi në xhep paketën e cigareve. Euforia e tij sikur avulloi. E marrtë dreqi! Që dje nuk kishte vënë cigare në gojë, i vendosur ta linte pas paralajmërimit të rreptë të mjekut. Kohët e fundit, po i dridheshin këmbët nën peshën e rëndë të trupit, dhe shpesh kishte marrje mendsh. Tension dhe kush e di çfarë tjetër, tha mjeku, dhe pa keqardhje i kërkoi të tmerruarit zotit Triko të linte duhanin dhe të kufizonte të ngrënët, që ai e kishte dobësi.

U xhindos dhe inatin ia nxori Vasilit, shërbëtorit të tij, një njeri i thjeshtë dhe i fuqishëm, por i bindur si ai qeni i mirë, që i kaloi vitet e fëmijërisë dhe të rinisë së tij duke punuar për zotin Triko, duke kryer punët e rënda dhe porosinë në dyqan, duke pastruar shtëpinë, duke larë - Vasili lart, Vasili poshtë - dhe duke dëgjuar kokulur, në heshtje dhe me bisht të syrit, ankesat dhe sharjet e të zotit.

Sepse zoti Triko e dinte shumë mirë se në cilën pikë, mirësjellja e shtirur pushon së qenë e vlefshme dhe kur zotëria mund të bëhet kërkues dhe brutal sa t'i dojë qejfi.

Por ndërkaq, ai shpërthim nuk i bëri mirë. Po i merreshin mendtë përsëri.

- M'u neverit ajo shtazë, - tha dhe u përpoq të fshinte me shami fytyrën e tij të djersitur.

Dora, e mpirë dhe e rënduar, nuk i bindej vullnetit të tij. E harroi cigaren dhe po rrinte i menduar. E kaloi paraditen i ulur në tavolinën e tij, pa humor, duke mos u dhënë asnjë urdhër nëpunësve të tij.

Nga dreka, e zuri papritur një dhimbje e fortë koke. Pika të mëdha djerse i rridhnin nga balli dhe nuk kishte fuqi që të ngrinte dorën e t'i fshinte. I vinte për të vjellë. U mbështet

me të dyja duart mbi tavolinën e punës dhe bëri një përpjekje të dëshpëruar për t'u ngritur. Si të që në ëndërr, iu duk sikur u ngrit dhe ecte drejt derës, në të njëjtin moment që kishte rënë përmbys mbi tavolinë; një trup i qullur, i rënduar.

Dy nëpunësit dhe Vasili vrapuan për ta ndihmuar. Dhe ndërkohë që dy nëpunësit po përpiqeshin t'i jepnin njëfarë ndihme dhe lëviznin sa andej-këtej si të shastisur, duke mos ditur se çfarë të bënin, Vasili qëndroi mënjanë dhe vështronte si i magnetizuar atë trup në gjendje të mjerueshme, i cili, vetëm pak momente më parë, përfaqësonte për të një forcë të pamëshirshme. Diçka e çuditshme po ndodhte brenda tij.

Më në fund, dikujt i vajti mendja të marrë në telefon mjekun.

Njerëzit u mblodhën në trotuar dhe bënin komente nga më të ndryshmet.

Gjëja e parë që bëri mjeku me të mbërritur, ishte të urdhëronte që të dilnin jashtë të gjithë ata që ishin grumbulluar brenda në dyqan. Në vazhdim, u përkujdes për të sëmurin dhe mori në telefon që të vinte një autoambulancë.

- Ta çojmë në spital, - tha mjeku. - Kush do të kujdeset për të në shtëpi?

I ulur në një kolltuk që e sollën nga shtëpia, i sëmuri vështronte përreth me një shikim të përhumbur. Goja iu shtrembërua dhe fytyrën e kishte tej mase të shpërfytyruar. Sa herë që merrte frymë thithte faqen e djathtë dhe pastaj e shfrynte nga buzët e tij të vulosura pf... pf... si ata që tymosin me çibuk.

Kur pa ata njerëz me të bardha të futeshin në dyqan duke mbajtur një barelë, në sytë e tij u dallua një shprehje paniku dhe zgjati dorën e tij të majtë, sikur donte të dëbonte larg

një vegim të padëshirueshëm. Por, i dërrmuar nga përpjekja që bëri, u shemb përsëri në kolltuk.

Kërkuan ndihmën e Vasilit që ta vendosnin të sëmurin në barelë. Dhe ai, teksa ngrinte atë masë të rëndë dhe të flashkët, ndjeu përsëri brenda vetes së tij diçka të ashpër, që ia largonte keqardhjen. Kishte kaq vite që dridhej përpara kësaj ngordhësire! Kështu si po e mbante tani prej sqetullave, nëse do ta lëshonte papritur, ai do të binte dhe koka e tij tullace, duke u përplasur tek pllakat, do të çahet si një shalqi. “Do të ishte shumë për të qeshur”, mendoi ai.

Kur e shtrinë në barelë, zoti Triko filloi të lëvizë në mënyrë të dëshpëruar, sikur donte të ngrihej. Lëvizte kokën majtas e djathtas dhe me shikimin e tij, me një “pa... pa... pa...” që nxirrte nga goja e tij e shtrembër, ai protestonte sikur donte të thoshte: “ku po më çoni?... nuk dua, jo, nuk dua... si do t’i lë unë të gjitha këto të mira që i dua aq fort?...”.

Në momentin që ngritën barelën, gjeti forcën të zgjaste dorën e tij të majtë dhe të kapej pas një tubi metalik të banakut. E mbante këtë tub me forcë, me të gjithë vullnetin që i kishte mbetur, dhe “pa... pa... pa...”, lutej ai duke iu marrë goja.

U kthyen duke vështruar mjekun dhe ai ua bëri me shenjë: hapjani dorën. I gatshëm në atë moment, Vasili mbërtheu atë dorë të urryer dhe ia hapi gishtat, duke shkërmoqur në mënyrë brutale rezistencën e tij të dëshpëruar.

Vështrimi i të sëmurit, që deri në atë moment ishte lutës, u mbërtheu për një moment, i mbushur me helm, mbi Vasilin, dhe pastaj u shua. Koka, e stërlodhur, iu kthye mënjanë.

Mjeku, që e njihte Trikon dhe sjelljet e tij prej aristokrati, e vuri në dhomë më vete të klasit të parë në spital dhe kërkoi që të qëndronte me të edhe Vasili, për t'i bërë shoqëri dhe për t'i shërbyer.

Pasdite erdhën nipërit e tij - një i ri dhe një e re - dhe dukej që nuk ndiheshin rehat me rrobat e mira që kishin veshur për këtë rast, dhe përpjekjes për t'u dukur të pikëlluar. Vajza mbante një tufë me lule dhe nuk dinte se çfarë të bënte me të. Më në fund, u gjet një infermiere që solli një vazo dhe ia mori nga dora tufën me lule. U përpoqën t'i thoshin xhaxhait të tyre fjalët që thuhet për këto raste, por u duk që nuk mbeti i kënaqur, vetëm u hodhi një vështrim të ftohtë luleve dhe mbesës së tij, e cila u mat të zgjaste dorën për t'i përkëdhelur ndoshta ballin, por u ndruajt dhe e tërhoqi dorën mbrapsht sapo dalloj vështrimin e tij.

Vasili qëndronte në një cep në korridor, vëzhgonte dhe ngrihej pakëz sa herë që kalonin pranë tij mjekë apo infermiere.

Kur po afronte nata, vizitorët u larguan nga spitali, mjekët bënë vizitat e fundit, infermieret përgatitën pacientët për të kaluar natën, dhe në atë gjysmerrësirë, në pavijone e korridore, u përhap një qetësi e mbushur me pritshmëri.

Vasili rrinte te divani që i shtruan brenda dhomës së zotit Triko dhe po e vështronte se si po thithte faqen dhe shfrynte, pf... pf... pf..., në mënyrë ritmike, këmbëngulëse, të pambarimtë.

Me kalimin e orëve, ai nervozohet gjithnjë e më shumë. Provoi të shtrihej, por pas pak e pa veten përsëri të ulur, me sytë të ngulur mbi atë krijesë të neveritshme, e cila thyente heshtjen me kaq vendosmëri - a thua se me këtë mënyrë,

tentonte t'i jepte edhe në këto momente rëndësi vetes - dhe në kokë Vasilit i vërtiteshin mendime të zymta.

I sëmuri hapi sytë, u mbllaçit duke përplasur gjuhën, ktheu kokën anash dhe belbëzoi duke iu marrë goja “pa... pa... pa...”, duke vështruar si i babëzitur gotën e ujit.

Vasili iu afrua, e ngriti pakëz dhe ia afroi gotën te buzët. Ai u mundua të pinte, e pati të vështirë, ngaqë edhe Vasilit nuk i jepej, uji iu derdh dhe e lagu në gjoks. “Pa... pa... pa...”, ia bëri i nervozuar dhe në vështrimin e tij shkrepiti diçka, që i kujtoi Vasilit torturuesin e mëparshëm, gjë që e zemëroi pa masë.

Mbështeti gotën mbi komodinë dhe filloi t'i gjuante si i tërbuar të sëmurit, me grushte brinjëve.

“Pa... pa... pa...”, ulëriti i sëmuri dhe filloi të përpëlitej e të rënkonte, si një ka i therur, duke lëvizur kokën majtas-djathtas dhe duke i hedhur Vasilit disa vështrime të mbushura me urrejtje. Pastaj mbeti palëvizur duke vështruar tavanin. Egërsia u zhduk nga vështrimi i tij dhe një pendim që nuk mund të përshkruhet me fjalë, iu përhap në fytyrë. Dy lot të rëndë u shfaqën dhe u rrokullisën faqeve të tij.

Vasili e mblodhi veten.

U shtri sa gjerë e gjatë në divan dhe pas pak e zuri gjumi.

Zoti Triko vdiq mëngjesin e ditës tjetër.

Nuk arriti të linte testament.

KËPUCË GRASH BOJËQIELLI

Nëse do t'i thoshe që e kishte organizuar në mënyrë sistematike punën e tij, Pirikli Sisamosi mund edhe të mos kuptonte se çfarë doje t'i thoshe. Ishte shitës vjetërsirash. Sillej gjithë ditën rrugëve me një trastë të madhe varur në sup, herë të mbushur dhe herë të tjera të zbrazur, që i vinte deri te veshkat dhe e detyronte ta mbante të përkulur trupin e tij të shtrembër. Ndërkohë, këtë punë modeste e kishte ngritur në nivelin e një rutine të organizuar më së miri, në saje të përvojës dhe dashurisë së tij të lindur për rregullin.

Lagjet i kishte ndarë në dy kategori - në ato ku njerëzit shesin rrobat që nuk i veshin më, dhe në ato ku njerëzit blejnë ato që nuk i veshin më të tjerët. Kishte edhe një tjetër - si mund ta quajmë, lagje apo kamp? - atje lart te Mantët, ku njerëzit flenë në lloj-lloj barakash, të ndërtuara me llamarinë apo dërrasa e baltë, dhe nuk kanë asgjë, as për të shitur, as për të blerë. Një zonë pa leverdi për biznesin e Pirikliut, megjithatë, ai këtu e kishte strehën e tij.

Kjo lagje ishte piktoreske, që kacavirrej në shpatin e zhveshur përmbi qytet, me rrugicat e saj të përpjeta dhe foletë provizore të njerëzve, të anuara dhe të mbështetura te njëra-tjetra që të mos binin, dhe të gjenin plot mënyra për t'u ngjeshur pa shkak dhe të shpalosnin, në pak metra katrorë terreni të përrthyer, diku një tarracë të vogël me bimë kacavjerrëse mbi mure me gurë të thatë, më tutje një ballkon që varej lezetshëm dhe guximshëm në boshllëk, diku tjetër shkallë që kafshonin shkëmbin, me oborret e rrethuara në mënyrë të çrregullt dhe brenda tyre, derra, pula, qen, por edhe fëmijë të vegjël, shumë fëmijë, që zhgërryeshin në baltë dhe që i hanin mizat.

- Gjithçka tjetër shkon e vjen. Po këta qurrashë, ore të pandjeshëm, përse i bëni dhe pastaj i braktisni mbi plehra? - pyeti i indinjuar Pirikliu dhe pastaj filloi të fliste nëpër dhëmbë, me fjalë të pakuptimta dhe të grindej me vete.

- ... Se mos na zhduket raca.

Po rrinte me tre të tjerë rreth një tavoline te kafeneja e vogël.

Të tjerët u gajasën.

- Se mos kemi dhe ndonjë gjë tjetër për t'u argëtuar? - tha me sarkazëm Mutai, shakaxhiu i grupit, duke mbyllur syrin e tij të shëndoshë dhe duke bërë një grimasë, që i dha fytyrës së tij pa dhëmbë një shprehje tmerrësisht qesharake, për shkak të syrit tjetër, atij me defekt, që kërcente jashtë i ënjtur dhe në ngjyrë të kuqërremtë, si një absces.

Ngriti dorën me pëllëmbën e shtrirë dhe e uli me nënkuptim midis kofshëve.

- Kjo na ka mbetur, - tha dhe qeshi me të madhe.

Por Pejorki e keqkuptoi dhe, befas, ktheu me fund gotën e rakisë dhe përplasi gotën mbi tavolinë.

- A, s'na lë rehat në hallet tona. Gjyq do të na bësh tani?
- tha dhe i hodhi një vështrim sfidues Pirikliut.

- M'u hap barku për hallet tuaja! - ia ktheu me shpoti tjetri. - Unë e kam fjalën vetëm për fëmijët. Ç'faj kanë fëmijët e shkretë, që t i mbjellë kështu në tym, çdo kokërr dembeli?

Fytyra e Pejorkit u errësua, por derisa të gjente një fjalë të rëndë që të kundërpërgjigjej, usta Themistoi u tregua më i shpejtë.

- Pa pushoni, bre burra, - ia bëri me zërin e tij si kabanë dhe shtriu dorën mbi tavolinë.

Mutai, që lëkundej si ndonjë marionetë mbi karrigen e tij, duke fërkuar duart, a thua se priste diçka të rëndësishme, u zhgënjye.

Pejorki i vuri fre zemërimit. "Në djall shkoftë", tha me vete.

Mbetën aty për njëfarë kohe të heshtur, duke vështruar gotat e tyre. Më në fund, Pirikliu u ngrit.

- Hajde, natën e mirë, - i përshëndeti.

- ... mirë, - mermëritën të tjerët, pa ngritur kokën.

Përsëri ishte i zemëruar me veten. Një mijë herë kishte thënë të mos përzihej në çështjet e tyre, jo se i interesonte se si do ta merrnin të tjerët, jo, nuk i bënte fare përshtypje, vetëm se nuk e gjente se për ç'arsye ai, Pirikliu, duhej ta vriste mendjen për të tjerët, të shqetësohej nëse atyre u pëlqente që të jetonin si buburreca. "A s'kanë shkuar në

djall, vulëhumburit? Koka bën, koka pëson! Kështu është jeta. Për ata do të mendoj unë tani, një njeri pa njeri, që përpiqem të mos katandisem si ata? Se mos e vrau njeri mendjen për mua ndonjëherë. A nuk kanë vajtur në djall”, tha përsëri me vete teksa kërkonte në terr që të gjente vrimën e bravës për të hapur derën e shtëpisë së tij me atë çelës të madh që nxori nga xhepi i pantallonave.

Mbylli derën me çelës dhe u gjend i vetëm në errësirën e thellë. Vajti deri te rafti në cep, zgjati dorën pikërisht te vendi ku ndodhej shkrepësja, e mori dhe ndezi llambën. Brenda në atë shtëpi përdhese, me lagështirë dhe tavan të ulët, çdo gjë ishte vendosur me rregull në vendin e duhur. Pirikliu hodhi një vështrim përreth dhe psherëtiu. “Kokën hëngshin. Rëndësi ka të mos ia kesh nevojën njeriu, të mos interesohesh për asnjeri.”

Tashmë ishte mësuar me vetminë e tij, ku gjeti strehë, duke iu përkushtuar të gjitha këtyre gjërave të pashpirta, që e rrethonin për kaq vite, besnike dhe të qëndrueshme, dhe t’u kushtonte përkujdesje të sinqerta, që nuk i ndeshi kurrë te njerëzit. Nëse kishte momente që rraskapitej dhe, duke mos mundur më që të mbështetej mbi iluzione të tilla, kërkonte shoqërinë e njerëzve, indinjohej shpejt dhe rikthehej në vetminë e tij.

U ul në karrige dhe mbeti aty për njëfarë kohe me kokën ulur.

Një buburrec doli i hutuar nga poshtë sëndukut dhe iu drejtua murit përballë, duke përshkuar diagonalisht dyshemenë e shtruar me pllaka. Ndiqte një trajektore vijëdrejtë, thua se kishte një qëllim të caktuar, u ndal për një moment në mes të rrugës, lëvizi i shqetësuar antenat e

veta dhe u nis përsëri me nxitim derisa vajti e u fut në një të çarë rrëzë murit. Pirikliu nuk po ia ndante sytë. I vinte pështirë nga buburrecat dhe dikur ishte munduar me çdo mënyrë që t'i zhdukte nga shtëpia e tij. Por përpjekjet e tij shkonin dëm, sepse ato krijesa të neveritshme shfaqeshin përsëri natën, me mijëra, vinin nga oborret dhe nga strofka të tjera jashtë shtëpisë. Kështu pra sajoi edhe ai një fener dhe e vari te trari i tavanit, për të ruajtur të paktën ushqimet.

Një palë këpucë bojëqielli vajzash me taka, të hedhura mbi tavolinë, me bukurinë dhe elegancën e tyre, talleshin me atë mjedis të mjerë përreth.

Sapo i pa, Pirikliut iu kujtua Anthulla dhe u përpoq të buzëqeshte, por u përmbajt. I mori dhe po i studionte, duke i kthyer sa andej këtej me ato gishtërinjtë e tij të trashë, që preknin ngathët, sikur kishin frikë se mos i plagosnin ato këpucë elegante të punuara me kaq kujdes. Ishin pothuajse të reja. “Kështu veprojnë disa vajza aristokrate, - mendoi. - Përzgjedhin gjënë më të shtrenjtë që ekziston, e veshin dy apo tri herë, dhe ia japin shërbyeses, që t'ia shesë mbledhësit të vjetërsirave. Pothuajse të papërdorura. Se mos shkelnin në tokë ato? Ato, zemra ime, jetojnë si shtojzovallet, flenë mbi pupla, ushqehen me ajkë qumështi dhe sheqer të kristaltë, shkelnin mbi sixhade dhe parkete... Po si i shkëlqyen sytë Anthullës nga dëshira për t'i pasur kur i pa këto këpucë! I mori në duar dhe i vështronte me admirim, i shtrëngoi në gjoks dhe pastaj m'i dha përsëri dhe më vështronte sikur po lypte. E habitshme. Ç'mund t'i bënte ato këpucë, me këmbët e saj të paralizuara? T'i mbante vetëm për bukuri? Por ç'më duhet mua, - tha me vete - dhe i flaku këpucët mbi tavolinë. Se mos më fali mua ndonjëherë dikush ndonjë gjë? Është

momenti tani të fillojmë të bëjmë shpirtdhembshurin dhe t'u falim dhurata bastardëve të njërit apo tjetrit? Të qeshin njerëzit me ne?"

Hariklluja punonte herë pas here si shërbyese, por më shumë përpiquej të nxirrte bukën e gojës me pe dhe me gjilpërë. Kishte dhe vajzën sakate, por kishte edhe bashkëshortin e saj dembel, Pejorkin, të cilit duhej t'i jepte pará kur vinte rrallë e për mall, por nuk vinte mend ta çonte në djall dhe të binte rehat nga ai! Kjo ishte punë e saj. Ç'i duhej Pirikliut? Punën ia bënte, s'kishte ankesa prej saj. Nga rrobat që blinte, i jepte disa për të ndrequr, të tjera për të arnuar, një tjetër për të vënë një kopsë, një tjetër për ta larë. Dhe e paguante me copë.

Por as në lidhje me çështjen e vajzës nuk ha pykë, budallaqja, e ka me pekule, të jetë e larë, e krehur, flokët lidhur me fjongo, dhe të rrijë duke parë qiellin. Është sakate dhe i dhimbset, nuk them, por me dhembshuritë dhe përkëdhelitë, nuk fiton gjë.

- Po dërgoje moj e ngratë, të mësojë të qepë e të presë, - i tha një ditë Pirikliu. - Duart i ka të shëndetshme. Çfarë do të bëhet me të nesër, kur ti të mbyllësh sytë?

Hariklluja u kthye nga ai, i hodhi një vështrim të errët dhe u bë gati të shpërthente, por u përmbajt, u kthye nga Anthulla, që ishte ulur pranë saj dhe e shikonte me sytë të hapur nga habia.

- Zemra ime, erdhi ora të vaditësh lulet e tua, - i tha dhe i përkëdheli kokën.

Fëmija kuptoi. Vendosi patericat poshtë sjetullave dhe me një lëvizje të shkathët u ngrit më këmbë dhe vajti - tok-tok si karkaleci - jashtë shtëpisë. Këmba e saj e majtë, vetëm sa e cikte tokën me gishta dhe mezi e mbante atë trup të brishtë, sa të bënte hapin e radhës dhe të mbështetej përsëri mbi patericë. Ndërsa këmba e djathtë i varej si rreckë.

Gruaja shpërtheu.

- Dëgjo këtu... Si i thua këto fjalë në sytë e vajzës? A nuk të vjen keq?

Pirikliu ndërkohë ishte penduar, por nuk e jepte veten.

- Për të mirën e saj i them, Harikllu. Po gënjej gjë?

Ajo uli kokën.

- Çfarë do që të bëj? Ta dërgoj të mësojë të qepë është një fjalë goje, por si ta lë të largohet prej meje, nëpër rrugë shko e eja, të ma tallin dhe të ma vrasin shpirtërisht, kaq e ndjeshme sa është?

- Do apo nuk do ti, Harikllu, këto do t'i vuajë, - iu përgjigj i qetë Pirikliu. - Më mirë t'i kalojë tani që është e vogël, që të ka edhe ty në krah, ku mund të mbështetet derisa të kalitet, sesa të mbetet nesër pa ndihmë dhe pa qenë në gjendje të bëjë diçka. Do ta shkelin me këmbë.

Pushoi dhe po priste, por gruaja mbeti me kokën ulur e nuk fliste.

- Unë vetëm një fjalë thashë, Harikllu, nëse nuk të pëlqen, harroje, - i tha, më në fund, Pirikliu. - Nënë je. Bëj si të të ndriçojë mendjen Zoti.

I hodhi këpucët brenda në trastën e tij të zbrazët dhe u largua.

Mbi tavolinë mbetën disa rroba, të cilat do të kalonte në mëngjes t'i merrte të rregulluara.

Anthulla rrinte në një cep, në parvazin e ulët ku ishin vënë në radhë vazot me lule dhe po shikonte perëndimin e diellit. Nuk e vuri re Pirikliun që kaloi aty pranë. Ndoshta edhe u shtir sikur nuk e pa.

Deri në moshë dymbëdhjetëvjeçare ishte një vajzë me trup të imët dhe e zbehtë. Fytyra e saj, e rrumbullakët, hundë pakëz të shtypur, me sy bojëqielli të theksuar, kishte një shprehje të çiltër, çuditërisht të hijshme. Flokët e saj, që kishin ngjyrën e kallinjve të pjekur, përfundonin në dy gërsheta të lidhur me fjongo bojëqielli. Pjesën më të madhe të kohës rrinte vetëm, sikur t’i ishte përkushtuar diçkaje, që vetëm ajo e shikonte. Dhe nëse ndodhte t’i flisje, zgjohej prej ëndërrimeve të saj dhe të vështronte në një mënyrë sikur donte të të thoshte: “Ej! Ah sikur ta dije! Vetëm sikur ta dije!”.

Pirikliu zakonisht flinte mirë, i mbledhur kruspull brenda një ndjesie sigurie, larg preokupimeve të huaja, që kultivonte me këmbëngulje, sepse e konsideronte si një lloj shpërblimi që jeta ia kishte hua për të gjithë vrerin me të cilën ajo e kishte vaditur.

Por këtë natë nuk mundi të qetësohej, vetëm vërtitej në dyshek dhe, herë pothuajse i përgjumur e herë zgjuar, shikonte dhe mendonte një varg gjërash të çuditshme. I dukej sikur ecte i vetëm nëpër rrugët e qytetit, i ngarkuar me trastën e tij, e cila, megjithëse ishte bosh, i rëndonte në sup si plumb. Rrugët ishin të shkreta dhe të heshtura. Një moment u mbushën nga britmat e tij, pa e ndier që kishte bërtitur vetë ai.

“Gjëra të vjetraaaaa!”